



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 128 Akti

Nr. 160 Vendimi

Tiranë, më 14.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|--------------------------|----------|
| Lulzim Hamitaj | Kryesues |
| Brunilda Bekteshi | Relatore |
| Firdes Shuli | Anëtar |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në Tiranë, në datën 5.6.2019, ora 9:30, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena,** me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,** miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998; **“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”,** të ndryshuar”; **Ligji nr. 84/2016,** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 49/2012,** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 20.3.2018, të trupit gjykues nr.1, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, për të tri kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, komisioner Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Në datën 17.7.2018 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 15.3.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes, vetëm për kriterin e pasurisë.
6. Në datën 25.3.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, me një afat 7 ditë nga data njoftimit; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
7. Në datën 01.04.2019, subjekti i rivlerësimit depozitoi në rrugë elektronike, por edhe postare, prapësimet lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kërkoi që hetimi administrativ të vijonte edhe për dy kriteret e tjera, të figurës dhe atë profesional, ndërsa për vlerësimin e kriterit të pasurisë kërkoi thirrjen e disa shtetasve në cilësinë e dëshmitarëve.
8. Në datën 12.4.2019, trupi gjykues u mblodh për të diskutuar mbi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të cilën vendosi me vendim të ndërmjetëm: i) rihapjen e hetimit administrativ për kriterin profesional dhe kriterin e figurës; ii) thirrjen e shtetasit D. B. në cilësinë e dëshmitarit dhe të shtetasit B. Gj. me të njëjtën cilësi, si dhe vlerësimin e panevojshëm, ii-a) të thirrjes së përfaqësuesit të shoqërisë ndërtimore “D.” sh.p.k., pasi, Komisioni kishte administruar kontratat përkatëse të lidhura me këtë shoqëri, ii-b) të thirrjes së shtetasit I. P., pasi vetë subjekti bënte me dije se ai ndodhej jashtë vendit, ii-c) të thirrjes së shtetasit D.T., pasi Komisioni kishte administruar kontratat e shitblerjes së automjetit të lidhura me këtë shtetase, si dhe deklaratën noteriale të saj në vitin 2019; si dhe t’i njoftojë subjektit të rivlerësimit këtë vendimmarrje.

9. Në datën 12.04.2019, Komisioni, me vendimin nr. 3, pas vlerësimit të shpjegimeve të dërguara nga subjekti në datën 01.04.2019, vendosi rihapjen e hetimit administrativ duke vijuar me hetime të mëtejshme shtesë për kriterin e figurës dhe atë të aftësive profesionale.
10. Në datën 12.04.2019, subjekti i rivlerësimit u njoftua për rihapjen e hetimit administrativ.
11. Në datë 17.05.2019, Komisioni, me vendimin nr. 4, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht, për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes për të tri kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit që (i) të paraqesë rezultatet shtesë pas rihapjes së hetimit, për faktet dhe rrethanat e reja të konstatuara për kriterin e pasurisë, pas dëgjesës së dëshmitarëve, për kriterin e aftësive profesionale, si dhe për kriterin e figurës, (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, me një afat 10 ditë nga data njoftimit; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
12. Në datën 27.05.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni në datën 17.05.2019.
13. Në datën 05.06.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 5, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 5.6.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.
14. Në datën 05.06.2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 05.06.2019, për të rifilluar në datën 14.6.2019 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Shkëlzen Cena ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në "Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting"; b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; c)

raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; f) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. (***) me shkresën nr. (***) prot., datë 22.1.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/1¹, rezulton se subjekti Shkëlzen Cena e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 24.01.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Gjithashtu, në referencë të nenit 32/5² të ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi (***)

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

² Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

❖ **Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2) të datës 24.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.**

1. Për deklarimin në lidhje me apartamentin e banimit me sipërfaqe 55.25 m², me adresë: Lagjja (***), p. (***), shk. (***), ap. (***), Kukës, fituar me kontratë shitjeje nr. (***), datë 20.12.1999, blerë në shumën 600.000 lekë të reja dhe rivlerësuar 3.500.000 lekë, në datën 14.8.2012, ku subjekti i rivlerësimit zotëron 50 %, me **burim krijimi të deklaruar**: kursimet e prindërve B. dhe F. C..

1.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.2 Gjatë hetimit Komisionit i rezultoi se në deklaratën për vitin 2003 subjekti kishte deklaruar këtë pasuri në shumën 500.000 lekë.

1.3 ZVRPP Kukës, me shkresën nr. (***).prot., datë 24.12.2018, ka konfirmuar këtë pasuri me nr. (***), e llojit apartament, me sip. 55.25 m², e regjistruar në vol. (***), f. (***), përfituar sipas kontratës së shitjes nr. (***).regj., nr.(***)kol, datë 20.12.1999, regjistruar në ZVRPP-në Kukës me certifikatë për vërtetimin e pronësisë datë 7.12.2000, e rivlerësuar në shumën 3.500.000 lekë.

1.4 Me kontratën e shitblerjes së apartamentit nr. (***).regj., nr. (***).kol., datë 20.12.1999, (nënshkruar te noter F. R. në Kukës), provë e administruar në praktikën e ZVRPP-së Kukës, rezultoi se subjekti, me cilësinë e blerësit, kishte blerë këtë pasuri nga shtetasit R. D., F. D., Xh. D., N. D. përfaqësuar me prokurë nga shtetasi M. K. .

1.4.a Megjithëse në përmbajtje pasqyrohej si shitëse edhe shtetasja B. D., në kontratë nuk rezultonte që ajo të kishte shprehur vullnetin e saj nëpërmjet nënshkrimit të përfaqësuesit ligjor.

1.4.b Nga verifikimi në praktikën e ZVRPP-së nuk rezultoi i administruar akti i përfaqësimit për realizimin e kësaj shitjeje.

1.5 Përsëri me një tjetër kontratë shitblerjeje nr. (***).rep., nr. (***).kol., datë 20.12.1999 (nënshkruar te noteri F. R.) për këtë apartament, dokument i depozituar nga vetë subjekti në dosjen e ILDKPKI-së³, rezultoi se ai kishte nënshkruar në të njëjtën datë blerjen e të njëjtës pasuri, përpara të njëjtit noter publik. Në këtë kontratë, përmes përfaqësuesit ligjor, ishte shprehur edhe vullneti i shtetasës B. D. .

1.5.a. Në lidhje me këto mospërputhje, për një hetim sa më objektiv, Komisioni⁴ ka pyetur subjektin, i cili ndër të tjera, ka deklaruar⁵ se: *... në konceptin dhe vlerësimin e tij juridik e ligjor, ka nënshkruar vetëm një kontratë të shitblerjes së apartamentit me nr. pasurie (***). dhe pikërisht, kontratën me nr. (***).rep., dhe nr. (***).kol., datë 20.12.1999, lidhur para noterit F. R. në Kukës. Kjo kontratë është hartuar dhe formuluar nga noteri me makinë shkrimi. Nuk mund të ketë dy kontrata me të njëjtin numër repertori dhe të njëjtën numër kol., kur bëhet fjalë për të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt kontrate. Si mund të nënshkruaja dy kontrata për të njëjtin objekt blerjeje?... Për sa i përket konstatimit të Komisionit, se, në njëërën kontratë kanë shprehur vullnetin katër persona dhe në kontratën tjetër kanë shprehur vullnetin për shitjesne pasurisë pesë persona, subjekti është shprehur se “...në vlerësimin tim, siç e theksova, është e njëjta kontratë, ku në njërin ekzemplar të kontratës janë shkruar me shkrim dore në fund të saj emrat e pesë personave, ndërsa në tjetrën janë shkruar po me shkrim dore emrat e katër personave, kam për të shpjeguar se të gjithë bashkëpronarët e pasurisë, familja D., e kanë*

³ Referojuni aneksit nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Referojuni pyetësorit datë 15.3.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵ Në datën 20.3.2019.

shprehur vullnetin e tyre të lirë në prokurën e posaçme, nëpërmjet të cilës i kanë dhënë tagër juridik përfaqësuesit të tyre M. K. ... për shitjen e saj... Në këtë prokurë përfaqësimi, konstatohet lehtë fakti se ka shprehur vullnetin e saj me shkrim edhe shtetasja B. D.... në fund të kontratës, siç konstatohet lehtë, janë të cituar dhe të shkruar me shkrim dore, vetëm si emra pala shitëse, ku në njërin prej ekzemplarëve të kontratës, duket se është harruar të shkruhet emri i shtetasës B. D., (kjo patjetër harresë e noterit)...

1.5.b Në mbështetje të deklarimeve, subjekti ka depozituar prokurën e posaçme nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 4.12.1999, vërtetim nënshkrimi datë 20.12.1999, vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 9.12.1999, si dhe planimetrinë e apartamentit.

1.5.c Nga verifikimi i këtij akti noterial rezultoi se prokura datonte përpara shitblerjes së pasurisë dhe se në të kishte shprehur vullnetin e saj edhe njëra prej bashkëpronareve të kësaj pasurie, shtetasja B. D. .

1.6 Gjithashtu, rezultoi se në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie ishte përcaktuar vlera prej 600.000 lekësh e blerjes së saj, ndërsa në deklaratën e vitit 2003, sikurse është pasqyruar më sipër, subjekti kishte deklaruar vlerën 500.000 lekë.

1.7 Komisioni hetoi lidhur me burimin e kësaj pasurie, nga ku konstatoi se subjekti, në deklaratën e vitit 2003, kishte deklaruar këtë pasuri me burim krijimi “me rrogë”, ndërsa në deklaratën “Vetting”, sikurse është pasqyruar më sipër, kishte deklaruar si burim *kursimet e prindërve të tij*.

1.7.a Subjekti, pasi është pyetur⁶ në lidhje me këtë mospërputhje, ka deklaruar se “...është e vërtetë se në deklaratën e vitit 2003 është deklaruar nga ana ime se ky apartament është blerë me të ardhurat nga rroga, por ky deklarim i imi, ka qenë rezultat i një lapsusi, apo më saktë të themi, i paplotë. Kjo, pasi ishte hera e parë që bëhej deklarim pasurie, jo vetëm për mua, por për të gjithë subjektet e rivlerësimit, ky deklarim, siç edhe Ju e keni parë, është bërë me shkrim dore dhe në këtë moment, pa asnjë qëllim, kam harruar që pas fjalës “rrogë” të shtoja fjalën e “prindërve”. Këtë fakt e kam pasqyruar edhe në deklaratën “Vetting”, ku është sqaruar se ky apartament është blerë me paratë e fituara nga paga ndër vite e prindërve të mi, të cilët më kanë ndihmuar në blerjen e apartamentit në vlerën 600.000 lekë, në qytetin e Kukësit, ku unë punoja, pasi ata jetonin në fshatin Bicaj. Unë kam filluar punë për herë të parë me datë 1.4.1998, si Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Kukësit, dhe për rrjedhojë nuk mund ta blija me rrogën time apartamentin, një vit më pas.”

1.8 Mbi të ardhurat e ligjshme të krijuara për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se: “... babai ka punuar gjatë gjithë kohës në ndërmarrje të ndryshme shtetërore derisa ka dalë në pension në vitin 2008. Ndërsa, nëna ka punuar gjatë gjithë kohës si infermiere-mami, deri sa ka ndërruar jetë në vitin 2002.”

1.8.a Në mbështetje të deklarimeve të tij subjekti ka depozituar: i) vërtetimet nr. (***) prot., datë 6.2.2019, nr. (***) prot., nr. (***) prot., dhe (***) prot., datë 6.2.2019, nr. (***) prot, datë 8.2.2019; ii) tri vërtetime nr. (***) prot., datë 7.2.2019, të Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore Kukës; iii) kopje të librezës së punës së babait; si dhe iv) kontratën nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 20.12.1999.

1.8.b Komisioni konstatoi se dokumentacioni i depozituar pasqyronte punësimin e prindërve të tij prej vitit 1961, por në asnjë rast nuk pasqyronte të ardhurat e përfituara nga këto punësime.

⁶ Referojuni pyetësorit datë 5.2.2019, në dosjen e Komisionit.

1.9 Komisioni hetoi për të ardhurat e përfituara nga punësimi⁷ i prindërve.

1.10 Në analizën financiare janë vlerësuar dhe janë përfshirë të ardhurat nga viti 1991 deri në vitin 1999, për shkak se për periudhën përpara vitit 1991, nuk rezulton të ketë referenca mbi raportin të ardhura/shpenzime. Po ashtu, Komisioni ka vlerësuar se të ardhurat dhe shpenzimet gjatë viteve 1961 – 1991 neutralizojnë njëra-tjetrën, dhe për pasojë nuk mund të shërbejnë si mundësi për të kursyer. Ky arsyetim ligjor dhe logjik ka shërbyer si arsye për të mos llogaritur të ardhurat e para vitit 1991 në analizën financiare.

1.11. Nga analiza financiare (shihni tabelën nr. 1) rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur burime financiare në shumën 437.069 lekë për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie dhe për këtë i kaloi atij barrën e provës për të provuar të kundërtën.

1.12 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit gjithashtu i rezultoi se dukej se: i) kishte mospërputhje në deklaratën “Vetting” mbi vlerën e deklaruar 600.000 lekë për blerjen e kësaj pasurie me vlerën 500.000 lekë deklaruar në deklaratën vjetore periodike për vitin 2003 dhe për pasojë i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

Tabela nr.1

| Analizë për vitet 1991 – 1999 | | |
|--------------------------------------|--|----------------------|
| | Përshkrimi | Vlera në Lekë |
| 1 | Të ardhura Nëna 1994 – 1996 | 165,977 |
| 1 | Të ardhura Nëna 1997 – 1999 | 278,984 |
| 2 | Të ardhura Babai 1991 – 1996 | 90,502 |
| 2 | Të ardhura Babai 1997 – 1999 | 167,003 |
| 3 | Shpenzime para vitit 1997, 70% e të ardhurave | 179,535 |
| 3 | Shpenzime pas vitit 1997, 5.000 lekë/person/muaj | 360,000 |
| 4 | Blerje Apartamenti | 600,000 |
| | Balanca (1+2-3-4) | (437,069) |

1.13 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

1.13.i Subjekti e ka kontestuar analizën financiare duke pretenduar se të ardhurat e prindërve të tij nuk e kanë burimin vetëm nga kursimet nga pagat e tyre, por edhe nga kursimet e krijuara nga të ardhurat e tokës dhe bagëti, për faktin se ata kanë jetuar në fshat. Subjekti ka deklaruar se nuk mund të depozitojë fatura apo dokumentacion që të vërtetojë aktivitetin në fushën e bujqësisë, pasi në atë kohë ky lloj aktiviteti ishte i përjashtuar nga taksat e tatimet dhe se, për herë të parë, është shprehur subjekti, aplikimi i taksave vendore në Republikën e Shqipërisë është bërë me ligjin nr. 8977, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, datë 12.12.2002.

1.13.ii Subjekti ka pretenduar se analiza financiare e kryer nga Komisioni vetëm për vitet 1991 – 1999 nuk mbështetet në ndonjë provë, ndërsa duhet të ishin marrë në vlerësim edhe të ardhurat e viteve 1961 – 1991. Gjithashtu, ai e pretendon të pambështetur logjikën e neutralizimit të mundësisë së krijimit të kursimeve përpara vitit 1991, ndërsa shpjegon se në

⁷ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 19.2.2019 dhe nr. (***) prot., datë 19.2.2019 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës.

periudhën në fjalë njerëzit kanë kursyer; disa i kanë mbajtur kursimet në shtëpi, disa në bankë, *e jo më kot*, ka thënë ai, shteti shqiptar në atë kohë kishte krijuar “Bankën e Kursimeve”, e cila natyrisht ishte një bankë shtetërore.

1.13.iii Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare duhet të ishin konsideruar të ardhura edhe kursimet e prindërve nga puna e tyre në tokën rreth shtëpisë, pemëve frutore, të ardhura nga mbajtja e bagëtive dhe shpendëve, por janë llogaritur në mënyrë statistikore vetëm të ardhurat nga pagat e tyre. Subjekti, gjithashtu, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka shpjeguar se babai i tij ka në pronësi sipërfaqe tokë truall dhe tokë arë sipas certifikatave përkatëse të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.

1.13.iv Në tërësi, subjekti ka pretenduar se mosmarrja parasysh e aktivitetit ekonomik, si dhe e kursimeve të prindërve të tij për periudhën 1966 – 1991, ka çuar Komisionin në konkluzion të gabuar lidhur me mungesën e burimeve të mjaftueshme financiare për blerjen e kësaj pasurie.

1.13.v Ndërsa, lidhur me konstatimin mbi mospërputhjen e deklaramit të vlerës për blerjen e kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”, krahasimisht me deklaramin në vitin 2003, subjekti ka saktësuar se ka qenë një lapsus/harresë, apo pakujdesi në pasqyrim, pasi ishte hera e parë e plotësimit të deklaratës, sepse në deklaratat e mëvonshme, duke nisur që nga ajo e vitit 2004 dhe deklaratën “Vetting”, është pasqyruar shifra e saktë 600.000 lekë.

1.14. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.14.i Trupi gjykues lidhur me dy kontratat e nënshkruara për blerjen e kësaj pasurie me të njëjtin numër rep, kol dhe datë, përpara të njëjtin noter, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe prokurës së depozituar për shprehjen e vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve për shitjen e kësaj pasurie, çmon se kontrata është e vlefshme dhe se nuk ka dyshime lidhur me elementë fiktivë në të.

Trupi gjykues, lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e prindërve nga aktiviteti i tyre ekonomik apo kursimet e krijuara nga periudha para vitit 1991, në kushtet që ai pas kalimit të barrës së provës nuk depozitoi asnjë dokumentacion justifikues ligjor, si dhe nuk provoi as plotësimin e kushteve të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, çmon se ato mbeten në kuadër deklarativ dhe nuk janë bindëse pasi:

- nga njëra anë, burimi i deklaruar “*kursimet e realizuara nga punët e ndryshme të prindërve të tij në bujqësi, në tokën e tyre, blegtori, pemët frutore, etj.*” është një burim i shtuar vetëm gjatë shpjegimeve të tij, i cili nuk rezulton të ishte deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe atë periodike dhe nga ana tjetër, për periudhën e hershme 1961 – 1991, për të cilën pretendohen këto kursime, ato mund të shërbejnë vetëm si të ardhura për të jetuar, dhe jo për të krijuar kursime për të investuar në blerjen e pasurive.

Megjithatë, për një vlerësim objektiv, për shkak të pretendimit për të ardhura të një periudhe të hershme, 1961 – 1991, trupi gjykues çmon se, edhe duke i marrë në konsideratë të ardhurat e këtyre viteve në raport me shpenzimet, ato nuk reflektojnë një ndryshim thelbësor në rezultatin financiar. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues vlerëson se edhe nëse do të merrej i mirëqenë fakti se prindërit e subjektit kanë kursyer, rezulton se pas vitit 1991 ka ndodhur ndryshimi i kursit dhe vlerës së monedhës shqiptare dhe se inflacioni i atyre viteve ishte rreth 15.8 %, çka do të thotë se niveli i përgjithshëm i çmimeve të konsumit në ekonomi u rrit me 15.8 % në krahasim me vitin e kaluar^[1], situatë kjo që ka vazhduar deri rreth vitit 1998. Kjo

^[1] https://bankofalbania.org/rc/doc/Të_flasim_thjesht_për_inflacionin_3383_1_6878.pdf

tregon se, me kursimet që mund të kishte krijuar çdo shtetas nuk mund të investonte për të blerë një pasuri⁸.

Trupi gjykues, lidhur me mospërputhjet e deklaramit në deklaratën për Veting, të shumës 600 000 lekë që ka shërbyer për blerjen e kësaj pasurie me shumën 500 000 lekë, deklaruar në deklaratën për vitin 2003, nisur nga faktet se, shuma 600 000 lekë, ishte saktësuar në deklaratën për vitin 2004, si dhe po kjo shumë është pasqyruar në kontratën noteriale, çmon, se kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaramin për vitin 2003, të shumës 500 000 lekë.

Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë bindëse, pasi në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, pasi:

- i. bazuar në analizën financiare, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie të deklaruar në deklaratën “Vetting”;
- ii. pretendimet e subjektit mbi nivelin e provueshmërisë së burimit të mjaftueshëm të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, rezultuan në nivel deklarativ;
- iii. bazuar në deklaratën “Vetting” dhe deklaratën periodike për vitin 2003, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë për sa i përket shumës së shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie.

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe shqyrtimit të rrethanave në tërësi, trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Për deklaramin në lidhje me përdorimin e kredisë në shumën 1 000 000 lekë për rikonstruksionin e këtij apartamenti

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

2.2 Gjatë hetimit administrativ Komisionit i rezultoi se subjekti, në deklaratën vjetore periodike të vitit 2007, kishte deklaruar rikonstruksion të pasurisë së parë, arsyetuar më sipër, (apartamentit 1+1 në qytetin e Kukësit), në shumën 800.000 lekë nga kredia e marrë në “BKT”, dega Kukës.

2.3 Komisioni verifikoi dhe analizoi praktikën bankare për shkak se, rezultoi se, me kontratën e kredisë nr.(***) rep., nr. (***) kol., datë 7.8.2006, subjekti kishte përfituar shumën prej 1.000.000 lekësh me qëllim “*blerje apartamenti*” për një afat shlyrjeje 120 muaj nga data e rimbursimit, dhe se për të garantuar këtë kredi u konstatua se ishte vendosur në hipotekë pasuria e paluajtshme apartament, me sipërfaqe 55.25 m², e përshkruar në pikën “1”.

2.4 Pas këtyre konstatimeve, Komisioni ka pyetur⁹ subjektin i cili, ka deklaruar *se kishte kryer punime në këtë apartament në vitin 2007, rikonstruksion në shumën 800.000 lekë, nga kredia e marrë në “BKT”, dega Kukës, me datë 23.8.2006, në vlerën 1.000.000 lekë, por duke qenë se materialet bliheshin në tregun e qytetit të Kukësit, këto blerje nuk shoqëroheshin me fatura... dhe se pas kryerjes së rikonstruksionit të apartamentit, kishte bërë edhe rimobilimin e tij, nga teprica e kredisë dhe kursimet në shumën 200.000 lekë përgjatë vitit 2007...*

Nisur nga qëllimi i marrjes së kësaj kredie, deklarami i përdorimit të saj me një tjetër destinacion, si dhe nga parashikimi i bërë në nenin 2.4 të kontratës së kredimarrjes, në të cilin

⁸ Në publikimin e “Bankës së Shqipërisë” mbi ndryshimin e vlerës së parasë në Shqipëri, vërehet se paraja kishte humbur rreth 18 herë vlerën e saj që nga dhjetori i vitit 1991, psh., për të blerë të njëjtën sasi malli, në vend të shumës prej 100 lekësh që nevojitej 10 vjet më parë, tashmë duheshin 1000 lekë.

⁹ Referojuni pyetësorit datë 5.2.2019 në dosjen e Komisionit.

thuej shprehimisht se: “Klienti garanton që kredia do të përdoret për qëllimin e sipërpërmendur, blerje apartamenti, në të kundërt, në rast se banka zbulon që kredia është përdorur për ndonjë qëllim tjetër, atëherë ajo ka të drejtë që të kërkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose në rast se gjykon të arsyeshme, në vend të aplikimit të veprimit të sipërpërmendur mund të aplikojë 1 % penalitet mbi shumën fillestare të kredisë”, Komisionit, bazuar te dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe deklaratimet e subjektit, i rezultoi se dukej se subjekti kishte vepruar në kundërshtim me kushtin e parashikuar në kontratën për përfitimin e kësaj kredie, duke ndryshuar destinacionin e saj dhe për pasojë i kërkoi të japë shpjegime.

2.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Ndër të tjera, subjekti ka pranuar se kjo kredi është përdorur për rikonstruksionin e apartamentit, për faktin se me këtë shumë kredie të dhënë nga banka nuk mund të blije një apartament tjetër. Subjekti ka pohuar se këtë fakt ia ka bërë të ditur verbalisht edhe bankës, ose më saktë ish-drejtorit së BKT-së, dega Kukës. Subjekti ka parashtruar gjithashtu se penaliteti i vendosur në kontratë ndaj tij ka qenë e drejtë e bankës dhe jo detyrim i saj, ndërsa parashtron se ka qenë i rregullt në shlyerjen e saj dhe se banka ka qenë në vëzhgim të vazhdueshëm të shlyerjes së detyrimeve nga ana e tij, ka qenë në vëzhgim të vazhdueshëm të zbatimit të kontratës dhe asnjëherë nuk ka bërë konstatime të ndonjë parregullsie në zbatimin e kontratës, pasi ndryshe do të kishte kërkuar kthimin e kredisë.

2.6 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues nisur nga prapsimet e subjektit çmon se është e vërtetë që zbatimi i penalitetit në parashikimin ligjor të kontratës së kredisë në rast të ndryshimit të destinacionit të saj ka qenë e drejtë e bankës, por nga ana tjetër vlerëson se reciprokisht, zbatimi i drejtë i kontratës kërkonte edhe njoftimin nga ana e subjektit se ai kishte ndryshuar destinacionin e përdorimit të kredisë.

Trupi gjykues duke e vlerësuar edhe këtë fakt në harmoni me konstatimet e rezultuara gjatë hetimit administrativ (të trajtuara më poshtë) mbi vërtetësinë dhe analizimin e akt marrëveshjes siguroese të depozituar nga subjekti në bankë, për përfitimin e kësaj shume, çmon se nuk janë bindëse deklaratimet e tij, se kishte bërë me dije drejtuesin e bankës mbi ndryshimin e destinacionit të kredisë, për shkak se sipas parashikimit kontraktual ky veprim do të passillte kthimin e palëve në gjendjen e mëparëshme, pra kthimin e kredisë në favor të bankës. **Në konkluzion trupi gjykues çmon se është vepruar në kundërshtim me parashikimet e kontratës së kredimarrjes.**

3. Në lidhje me aktmarrëveshjen nr. (*) , datë 11.7.2006 me Premtim Shitje të Pasurisë së Paluajtshme me shtetasin D. B., për një apartament 1+1.**

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

3.2 Në praktikën e kredimarrjes për shumën 1 000 000 lekë të pasqyruar më sipër, u konstatua se ishte depozituar aktmarrëveshja siguroese nr. (***) , datë 11.7.2006 me Premtim Shitjeje, sipas së cilës shtetasi D. B. i shiste subjektit të drejtat reale të përfituara nga kontrata e sipërmarrjes nr. (***) , datë 17.3.2006, për çmimin 40.500 euro, kontratë kjo e cila rezultoi gjithashtu e administruar në praktikën bankare.

3.2.a Komisionit i rezultoi se me kontratën e kredisë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 7.8.2006 subjekti kishte përfituar shumën 1 000 000 lekë me qëllim “blerje apartamenti” për një afat shlyrje 120 muaj nga data e rimbursimit, dhe se për të garantuar këtë kredi ai kishte vendosur

në hipotekë pasurinë e paluajtshme apartament me sipërfaqe 55.25 m² të përshkruar në pikën “1”.

3.2.b Në datë 7.8.2006 rezultoi se subjekti kishte hipotekuar këtë pasuri me kontratë hipotekimi nr.(***), në favor të “BKT”-së.

3.2.c Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit të rivlerësimit nr. (***) nga “BKT”, rezultoi se kredia ishte disbursuar në datën 23.8.2006, në shumën 980.000 lekë dhe po në të njëjtën datë ai kishte tërhequr këtë shumë *cash*.

3.3 Sipas kontratës së sipërmarrjes (pas të cilës ishte nënshkruar edhe aktmarrëveshja siguroese) rezultonte se shtetasi D. B. kishte porositur pranë shoqërisë “D.” sh.p.k., ndërtimin e një apartamenti banimi me adresë: Rr. “I. D.”, përshkruar si: apartament 1+1, kati II banimi dhe se, bazuar në nenin 4 të saj, pagesa parashikohet të kryeje në tri këste, përkatësisht, 28.000 euro në datën e nënshkrimit të kontratës 17.3.2006, 8.000 euro brenda muajit janar të vitit 2007 dhe 4.500 euro me dorëzimin e objektit brenda muajit qershor.

3.4 Komisionit i rezultoi se sipas aktmarrëveshjes siguroese, me nënshkrimin e këtij akti, datë 11.7.2006, subjekti i rivlerësimit i kishte paguar shtetasit D. B. shumën 28.000 euro.

3.5 Po sipas kësaj aktmarrëveshjeje rezultonte se subjekti do të përgjigjej për pagimin e kështit të dytë dhe të tretë, përkatësisht në janar 2007 dhe qershor 2007, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, si dhe me ndërmjetësimin e shtetasit D. B. .

3.6 Për të qartësuar këtë situatë, Komisioni ka pyetur¹⁰ subjektin e rivlerësimit, për të cilën ai ka deklaruar se nga “BKT” nuk iu dha kredi në atë masë, sipas bisedimeve që kishin bërë, pasi kishte edhe dy kredi të tjera personale në “Raiffeisen Bank” ... dhe se marrëveshja siguroese ishte zgjidhur në heshtje, pasi nuk kishte asnjë kontraditë me z. B. .

3.7 Në deklaratën vjetore periodike 2006 rezultoi se subjekti kishte deklaruar këtë kredi me përshkrim, “*gjendje cash në shumën 1.000.000 lekë*”... “*apartamenti nuk është blerë akoma pasi nuk ramë dakord për çmimin*”.

3.8 Nuk rezultoi që subjekti të kishte deklaruar këtë aktmarrëveshje, as në deklaratën “Vetting” dhe në asnjë prej deklaratave të interesave periodike private.

3.9 Nuk rezultoi që subjekti të kishte nënshkruar ndonjë akt ligjor për të revokuar aktmarrëveshjen siguroese.

3.10 Nuk rezultoi që subjekti të kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2006 detyrimin që ai kishte pasur sipas aktmarrëveshjes për të paguar në vitin 2007 dy këstet e tjera të pasurisë, të cilën, sipas deklarimit të tij, nuk e kishte blerë ende pasi nuk kishte rënë dakord për çmimin.

3.11 Komisioni ka pyetur¹¹ subjektin mbi burimin e të ardhurave për krijimin e shumës 28.000 euro, si dhe për pagesën e kësaj shume z. D. B., për kryerjen e pagesave të kësteve të tjera të këtij apartamenti, si dhe për arsyet që subjekti nuk e kishte deklaruar blerjen e këtij apartamenti, ku ndër të tjera, ai ka deklaruar se: “*kur kam takuar shokun tim D. në Kukës, ...në një moment i thashë se kam dëshirë të blej edhe unë një apartament të vogël në Tiranë, po mora kredi në bankë, sepse doja të largohesha nga Kukësi. Dhe kështu, me datë 11.7.2006, bëmë edhe marrëveshjen e mësipërme. Nëse unë do merrja kredinë menjëherë, ai do të bisedonte me shoqërinë e ndërtimit “D.” që të m’i kalonte mua të drejtat që buronin nga kontrata e sipërmarrjes nr. (***) rep., dhe nr. (***) kol., datë 17.3.2006, me të cilën ai kishte porositur një apartament 1+1, dhe unë do t’i paguaja edhe shumën prej 28.000, që ai ia kishte paguar*

¹⁰ Referojuni pyetësorit datë 5.2.2019, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Referojuni pyetësorit datë 5.2.2019, në dosjen e Komisionit.

si këst shoqërisë ditën e hartimit të kontratës së sipërmarrjes. Pra, ditën e hartimit të aktmarrëveshjes datë 11.7.2006, nuk i është bërë asnjë pagesë në dorë apo me bankë D., pasi realisht nuk kisha të ardhura përveç pagës time dhe të bashkëshortes, por mendoja të merrja shpejt kredi bankare, dhe t'ia jepja. Fakti që noteri e ka shkruar në aktmarrëveshje se me nënshkrimin e saj janë likuiduar 28.000 euro në dorë, kam bindjen se është lapsus i tij, dhe duke qenë së kishim njohje shoqërore të tre bashkë, nuk e kemi vënë re atë gabim. Nësë pyetet noteri nga ana e Juaj, jam i sigurt se do ta dëshmojë një gjë të tillë. Realizimi i kësaj aktmarrëveshjeje me nr. (***) , datë 11.7.2006, u bë i pamundur, pasi unë mora kredi në “BKT” vetëm 1.000.000 lekë, me datë 23.8.2006, një muaj më pas, dhe faktikisht kjo marrëveshje u zgjidh në heshtje, pasi nuk kishim asnjë kontradiktë me D. . . . ndërkohë, shtetasi D. B., pak muaj më pas ka revokuar edhe kontratën e sipërmarrjes nr(***)rep., dhe nr. (***) kol., datë 17.3.2006, për porositjen e apartamentit 1+1, sepse kishte porositur një apartament tjetër me sipërfaqe më të madhe, në një seksion tjetër të asaj godine me kompozicion 2+1, me kontratën e porosisë me nr. (***) rep., dhe nr. (***)kol., datë 21.4.2007, apartament të cilin e ka në pronësi dhe sot dhe ku unë banoj me qira.

3.12 Subjekti, së bashku me deklarimin e tij, ka depozituar edhe kontratën e porosisë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.3.2006, sipas të cilës shtetasi D. B. ka porositur apartamentin 1+1, kontratën e porosisë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 21.4.2007, sipas të cilës z. B. ka porositur apartamentin 2+1, në të njëjtin objekt në Tiranë, aktmarrëveshjen nr. (***) , datë 11.7.2006, si dhe deklaratën noteriale të këtij shtetasi, me nr. (***) rep., dhe nr. (***) kol., datë 9.2.2019.

3.13 Subjekti ka deklaruar se nga verifikimet e kryera nga ana e tij, për të sqaruar në mënyrë shterruese këtë pyetje, në lidhje me apartamentin 1+1, që përmendet në kontratën e sipërmarrjes me nr. (***) rep., dhe nr. (***) kol., datë 17.3.2006, dhe aktmarrëveshjen e datës 11.7.2006, i ka rezultuar se ky apartament është blerë nga shtetasi D. V. P., (me të cilin nuk kam asnjë lloj lidhjeje), me kontratën nr. (***) rep., dhe nr. (***)kol., datë 10.7.2010, me shitës shoqëria “D.” sh.p.k., hartuar para noterit R. S. .

3.14 Në kontratën e sipërmarrjes nr. (***) , datë 21.4.2007, lidhur midis shtetasit B. dhe shoqërisë “D.” sh.p.k., për porosinë e apartamentin 2+1, në fund të nenit 7 është cituar shprehimisht: “Palët deklarojnë se kontrata e sipërmarrjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.3.2006 lidhur midis “D.” sh.p.k., dhe D. B., shfuqizohet, palët i kanë shlyer detyrimet karshi njëri-tjetrit (pasi sipërmarrësi ia ka kthyer porositësit të gjithë këstet e paguara prej tij) dhe si pasojë kjo kontratë nuk sjell më asnjë pasojë juridike midis tyre.”

3.15 Në kronologji të pagimit të kësteve për këtë pasuri, gjithashtu ka rezultuar se sipas marrëveshjes sigurorese këstet do të paguheshin nga subjekti i rivlerësimit.

3.16 Komisioni kreu analizën financiare (shihni tabelën nr. 2) lidhur me aftësinë paguese të shumës 28.000 euro në vitin 2006, nisur nga investimet e kryera në këtë vit, në raport me të ardhurat dhe shpenzimet, e cila pasqyrohet në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 2

| Analizë për vitin 2006 | |
|--|------------------|
| Pasuri | 6,290,527 |
| Automjet tip “Mercedes Benz 190 D”, targa (***) | 400,000 |
| Aktmarrëveshje për blerje apartamenti (vl. ap. 40.500 euro) | 5,009,972 |
| Diferencë likuiditeti | 880,555 |
| Detyrime | 2,876,670 |
| Kredi në “Raiffeisen Bank”, 400.000 lekë (31.5.2005) | -293,047 |
| Detyrimi i mbetur për aktmarrëveshjen “blerje apartamenti në Tiranë” | 1,546,288 |

| | |
|---|-------------------|
| Kredi konsumatore në “Raiffeisen Bank”, 700.000 lekë (2.3.2006) | 636,615 |
| Kredi për blerje apartamenti në “BKT”, 1.000.000 lekë (7.8.2006) | 986,815 |
| PASURI NETO (PASURI - DETYRIME) | 3,413,857 |
| Të ardhura të dokumentuara | 1,201,976 |
| Të ardhura të dokumentuara, subjekti | 908,626 |
| Të ardhura të dokumentuara, bashkëshortja e subjektit | 293,350 |
| Shpenzime | 447,681 |
| Shpenzime jetese sipas deklaramit të subjektit | 288,000 |
| Shpenzime sipas sistemit TIMS | 37,111 |
| Interesa, kredia në “Raiffeisen Bank” (400.000 lekë) | 16,856 |
| Interesa, kredia në “Raiffeisen Bank” (700.000 lekë) | 80,048 |
| Interesa, kredia në BKT (1.000.000 lekë) | 25,666 |
| Likuiditete në fillim të vitit | 110,391 |
| Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, paga e subjektit | 118,121 |
| “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja | -7,731 |
| Likuiditete në fund të vitit | 990,946 |
| <i>CASH</i> | 1,000,000 |
| Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, paga e subjektit | -2,639 |
| “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja | -6,415 |
| Analiza (Të ardhura dokumentuar – Pasuri neto – Shpenzime) | -2,659,562 |

3.17 Nga analiza e fakteve dhe rrethanave për këtë pasuri, si dhe nga analiza financiare, Komisionit i rezultoi se subjekti: (i) nuk kishte deklaruar në deklaratën “Vetting” shumën 28.000 euro me të cilën kishte paguar këstin e parë të apartamentit 1+1 sipas aktmarrëveshjes siguroese nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.7.2006, me premtim Shitje të Pasurisë së Paluajtshme; (ii) dukej se kishte kryer deklaramit të rremë; (iii) nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike 2006, marrëdhënien e interesit pasuror, aktmarrëveshjen siguroese nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.7.2006, me premtim Shitje të Pasurisë së Paluajtshme; (iv) dukej se nuk kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2006 detyrimin e dy kësteve të tjera të pasurisë, të parashikuara në aktmarrëveshjen siguroese, për të paguar në vitin 2007; (v) dukej se nuk kishte deklaruar në mënyrë konsistente në vitin 2007 se çfarë ishte bërë me këtë aktmarrëveshje; (vi) bazuar te dokumentacioni i vënë në dispozicion dukej se kishte mungesë të burimeve financiare në shumën prej 2.659.562 lekësh, për të paguar këstin 28.000 euro, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera në vitin 2006.

3.18 Pas kalimit të barrës së provës dhe kërkimit të subjektit për të pyetur me cilësinë e dëshmitarëve noterin publik z. B. Gj. dhe shtetasin D. B. të cilët ishin të përfshirë në aktmarrëveshjen siguroese, Komisioni ka pyetur të dy shtetasit, ka administruar procesverbalet përkatëse me dëshmitë e tyre, pas analizimit të të cilëve i ka kaluar subjektit barrën e provës për faktin se janë konstatuar: (i) mospërputhje midis deklaramit të bërë nga subjekti kur është shprehur në prapësimet në rezultatet e hetimit¹² se kishte bindjen¹³ *se është lapsus i noterit, apo pakujdesi e tij*, shkrimi në aktmarrëveshje se ishin likuiduar 28.000 euro në dorë, dhe se nuk e kishte vënë re këtë gabim dhe deklarimeve të noterit publik z. Gj. kur shprehej se vlera 28.000 euro nuk është lapsus është vullneti i tyre... .. se vlera 28.000 euro ka qenë vullneti i tyre çfarë

¹² Referojuni pikës 3.9.

¹³ Referojuni edhe përgjigjes së dhënë në pyetësorin datë 5.2.2019 gjatë hetimit administrativ, pasqyruar në rezultatet e hetimit në pikën 3.13. (cituar shprehimisht: “Fakti që noteri e ka shkruar në aktmarrëveshje se me nënshkrimin e saj janë likuiduar 28.000 euro në dorë, **kam bindjen se është lapsus i tij**, dhe duke qenë së kishim njohje shoqërore të tre bashkë, nuk e kemi vënë re atë gabim.”).

ata dëshironin të shkruanin, *nuk ka lapsus* por është shprehje e palëve...; (ii) mospërputhje midis deklarimit të z. D. B. kur shprehet se, *akti i nënshkruar nuk është i vërtetë...* dhe se noterit ia kishim bërë me dije këtë fakt dhe deklarimeve të noterit publik z. Gj. kur shprehet se *kishte pasur besim që ky akt kishte qenë i rregullt* dhe për kohën që ishte bërë ka qenë gjithçka normale... se *nënkuptohet që është likuiduar, por s'mund të paragjykoj një veprim... se nuk kishte këtë dijeni që deklarimet e palëve nuk ishin të vërteta...*se palët janë shprehur që është dhënë kësti i parë...etj.; (iii) mospërputhje midis shumës së kërkuar kredi nga Ju në BKT, megjithëse nuk e deklaroni atë, me deklarimet e z. D. B., i cili ka pohuar se *ju keni aplikuar* në bankë për 9 milion, si dhe ... se nuk dinte saktësisht, por ju kishit aplikuar për 900.000 apo 1 milion lekë... dhe se; (iv) në tërësi ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit dhe dëshmitarëve të pyetur.

3.19 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Ndër të tjera, subjekti në parashtrimet e tij ka deklaruar se ... “ *nuk e ka paguar këtë shumë, se pasqyrimi nga noteri i pagimit të kësaj shume në aktmarrëveshjen siguruese premtim shitjeje ka qenë lapsus, gabim apo pakujdesi e noterit. Subjekti ka pretenduar se në vlerësimin e tij nuk ka mospërputhje në deklarimet e këtyre dëshmitarëve. Kur dëshmitari B. ka deklaruar se akti i nënshkruar nuk është i vërtetë, ka pohuar se shuma e shkruar në aktmarrëveshje nuk është dhënë as në zyrën e noterit dhe as jashtë saj, as më herët, e as më vonë, ndryshe nga si e percepton Komisioni. Subjekti ka pretenduar se noteri këtë fakt ka deklaruar, se nuk është dhënë asnjë shumë në zyrën e tij. Po ashtu, subjekti ka sqaruar se nuk kishte pasur të ardhura për të paguar shumën prej 28.000 eurosh (njëzet e tetë mijë). Gjithashtu, ai ka shpjeguar se për marrjen e kredisë ishte vënë hipotekë apartamenti i banimit në Kukës, dhe jo ndonjë pasuri tjetër, se kjo aktmarrëveshje nuk ka pasur asnjë fuqi ligjore, por ka qenë thjesht një marrëveshje e mbetur në letër mes dy personave.*

3.20 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe provave: (i) se aktmarrëveshja siguruese është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe pala tjetër kontraktore në vullnet të lirë e të plotë përtej çdo presioni apo lajthitjeje, siç edhe është deklaruar nga noteri publik, por edhe shtetasi B. në cilësinë e dëshmitarëve; (ii) se sipas këtij akti subjekti ka përfituar të drejta reale të një pasurie; (iii) se sipas këtij akti subjekti ka paguar në favor të palës tjetër kontraktore shumën 28.000 euro; (iv) se subjekti ka depozituar këtë aktmarrëveshje në praktikën bankare të kredimarrjes me qëllim përfitimin e kësaj të fundit; (v) se banka është vënë në lëvizje mbi këtë aktmarrëveshje; (vi) se subjekti nuk rezulton ta ketë revokuar këtë akt, vii) se pretendimi nga subjekti, se ai nuk e ka paguar asnjëherë shumën 28 000 euro, do ta bënte aktin fiktiv, të hartuar e nënshkruar vetëm me qëllim marrjen e kredisë;

arrin në konkluzionin se për sa kohë kjo aktmarrëveshje ka qenë dhe është në fuqi, rezulton se subjekti i) nuk ka deklaruar në deklaratën veting shumën 28000 euro me të cilën kishte paguar këstin e parë të apartamentit 1+1 sipas Akt Marrëveshjes siguruese Nr. (***) Rep, Nr. (***)Kol, datë 11/07/2006, me premtim Shitje të Pasurisë së Paluajtshme;ii) nuk ka deklaruar në deklaratën periodike 2006, marrëdhënien e interesit pasuror, Akt Marrëveshjen siguruese Nr. (***) Rep, Nr. (***) Kol, datë 11/07/2006, me premtim Shitje të Pasurisë së Paluajtshme, si dhe detyrimin e dy kësteve të tjera të pasurisë, të parashikuara në akt marrëveshjen siguruese, për të paguar në vitin 2007;iii) nuk ka deklaruar në mënyrë konsistente në vitin 2007 se çfarë ishte bërë me këtë akt marrëveshje; iv) bazuar në analizën financiare, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar shumën 28 000 euro.

Në kushte të tilla, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe shqyrtimin e rrethanave në tërësi, trupi gjykues, arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4. Në lidhje me likuidimin e kredisë në shumën 1 000 000 lekë nga disa shtetas

4.1 Komisioni hetoi në lidhje me likuidimin e kësaj kredie si dhe lidhur me faktin nëse subjekti gjendej në konflikt interesi me personat¹⁴ të cilët rezultuan se kishin kryer shlyerje për llogari të tij.

- ✓ Pas deklarimeve¹⁵ të vetë subjektit të rivlerësimit, por edhe nga korrespondenca e mbajtur me organin e prokurorisë, Komisioni nuk konstatoi shkelje në likuidimin¹⁶ e kësaj kredie.

5. Në lidhje me deklarinimin autoveturë “Volksagen”, tipi Passat, viti 2006, me targa TR (***) , regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 3.10.2009, blerë në shumën 1.000.000 lekë. Detyrimi doganor: në vlerën 294.172 lekë. Pjesa takuese: 50 %, me burim krijimi sipas deklaratës “Vetting”: kredi sipas kontratës së kredisë nr. (***) , datë 9.11.2009, marrë në “Credins Bank” sh.a.

5.1 Për këtë pasuri ILDKPKI-ja është shprehur se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e DPSHTRR-së.

5.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

5.3 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën vjetore periodike 2009 nga bashkëshortja e subjektit në shumën 1.000.000 lekë, në pjesë takuese 100 %.

5.4 Me kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 3.10.2009¹⁷, nënshkruar te notere Sh. Gj., zyra e noterisë Tiranë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë këtë automjet nga shtetasja D. T., në shumën 1.000.000 lekë.

5.5 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 20.12.2018¹⁸, ka depozituar praktikën që i përket këtij automjeti. Nga praktika ka rezultuar se me kontratën e shitjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 9.10.2009 nënshkruar te noteri B. Gj., zyra e noterisë Kukës, bashkëshortja e subjektit ka blerë nga shtetasja D. T. (me banim në Amerikë) këtë automjet për çmimin prej 6.000 eurosh, shumë të cilën blerësi, sipas kësaj kontrate, e ka likuiduar jashtë zyrës noteriale.

5.5.a Nga verifikimi i sistemit TIMS ka rezultuar se shtetasja D. T. ka dalë nga aeroporti i Rinasit në datën 8.10.2009, në orën 5:50.

5.5.b Në dokumentacionin e ardhur nga DPSHTRR-ja, automjeti është pasqyruar në destinacion¹⁹ (Morinë) në datën 9.10.2009.

- Komisioni hetoi në lidhje me burimin e kësaj pasurie, nga ku i rezultoi se:

¹⁴ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 8.2.2019 drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, Kukës dhe Dibër, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. (***) prot., datë 11.2.2019, në dosjen Komisionit.

¹⁶ Referojuni deklaratës noteriale nr. (***) , datë 17.11.2016, të “BKT”-së ku rezulton se kjo e fundit ka hequr dorë nga hipoteka e kësaj pasurie meqenëse kredia për sigurimin e së cilës ajo ishte hipotekuar është shlyer plotësisht nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁷ Referuar kontratës në dosjen e ILDKPKI-së (aneksi nr. 4/3).

¹⁸ Pas shkresës nr. (***) prot., datë 13.12.2018, të KPK-së, në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Referojuni praktikës së DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

5.6 Nga aktet e depozituara nga “Credins Bank”²⁰ është konstatuar se subjekti me kontratën e kredisë nr. (***), datë 9.11.2009, noterizuar me nr. (***), kishte marrë hua shumën 1.200.000 lekë me afat 60 muaj me qëllim, blerje makine dhe mobilim shtëpie.

5.7 Në marrëveshjen siguroese nr. (***), datë 9.11.2009 të kësaj kredie, në objektin e saj u konstatua se ishte vendosur si garanci kjo pasuri, por në vlerën 1.400.000 lekë, si dhe disa orendi shtëpiake.

5.8 Kredia rezultoi të ishte marrë një muaj më vonë se të ishte realizuar blerja e automjetit dhe për rrjedhojë ajo nuk mund të shërbente si burim për blerjen e tij.

5.9 Nga llogaria e “Credins Bank” rezultoi se kredia ishte disbursuar në datën 9.11.2009, në shumën 1.188.000 lekë dhe, po ashtu ishte tërhequr në datën 12.11.2009.

5.10 Komisioni ka pyetur²¹ subjektin lidhur me këto mospërputhje, për të cilët ai ka konfirmuar vërtetësinë e faktit se *kredia është marrë pas nënshkrimit të kontratës për blerjen e mjetit, me datë 3.10.2009, nga bashkëshortja e tij, duke deklaruar se kishte rënë dakord me shitësen e makinës, shtetasen D. T., që kontratën ta lidhnin paraprakisht dhe likuidimin ta bënin pas marrjes së kredisë, siç edhe ka ndodhur. Atëherë, ka deklaruar subjekti, ishte rutinë që nga ana e noterit, në kontratë të shkruhej se palët janë likuiduar për shumën, por në të vërtetë, likuidimi i saj nuk ishte bërë ditën e hartimit të kontratës. Në lidhje me vlerën reale të mjetit subjekti ka shpjeguar se është vlera e deklaruar në kontratën e shitjes. Në lidhje me faktin se vlera e deklaruar tek banka ka qenë më e madhe se vlera e mjetit, kjo ka ndodhur për shkak se mjeti kishte nevojë për riparime, si dhe një pjesë e këtyre të ardhurave do të përdorej për taksat e mjetit dhe për kalimin e pronësisë së këtij mjeti në emrin e bashkëshortes... kredia e mësipërme e marrë në “Credins Bank”, është përdorur e gjitha për blerjen e automjetit tip “Volksagen”, targimin dhe shërbimet e tij. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar²² se, shuma e përgjithshme e detyrimit doganor (vlera e zhdoganimit) ka qenë 294.172 lekë dhe se pagesa është bërë nga ana e tij, pasi shuma e blerjes së makinës prej 1.000.000 lekësh, përfshinte vlerën e makinës me targa të huaja, dhe transportin e saj, dhe jo doganën. Subjekti ka deklaruar se, së bashku me të ka qenë edhe bashkëshortja e tij dhe shtetasja D. T., meqenëse do të shkonin për Kukës, ajo kishte shkuar me ta për të parë Kukësin, si edhe që makina të provohej për gjendjen e saj teknike.*

5.11 Komisioni kreu analizën financiare lidhur me aftësinë paguese të kësaj pasurie, nga e cila i rezultoi se subjekti nuk gjendej në balancë negative.

5.12 Përtej konstatimit financiar, Komisionit nga analiza e fakteve i rezultoi se për këtë automjet bashkëshortja e subjektit kishte nënshkruar dy kontrata në kohë të ndryshme, në zyra të ndryshme noteriale, me vlera të ndryshme monetare; se dukej se pala shitëse nuk kishte qenë prezent në hartimin dhe nënshkrimin e kontratës nr. (***), rep., nr. (***), kol., datë 9.10.2009, dhe për pasojë nuk kishte shprehur vullnetin e saj për kalimin e kësaj pasurie; se bazuar në dokumentacionin e administruar dukej se kishte mospërputhje midis çmimit të blerjes së makinës të deklaruar nga subjekti në marrëveshjen siguroese dhe çmimeve të parashikuara në kontratat e blerjes, dhe për këto i kaloi atij barrën e provës. Po ashtu, Komisionit i rezultoi se kjo pasuri në deklaratën “Vetting” ishte deklaruar në pjesë zotëruese 50 %, ndërsa në deklaratën periodike për vitin 2009 ishte deklaruar nga bashkëshortja e subjektit në pjesë takuese 100 %, dhe për këtë i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

²⁰ Referojuni shkresës nr. (***), prot., datë 16.8.2018, në dosjen e Komisionit.

²¹ Referojuni pyetësorit të datës 5.2.2019 në dosjen e Komisionit.

²² Me pyetësorin datë 15.3.2019, në dosjen e Komisionit.

5.13 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se:... *“kredia është përdorur pikërisht për blerjen e automjetit dhe se kontrata e shitjes është bërë më parë, por shitësit i është dhënë vlera vetëm pasi kam marrë kredinë. Pikërisht për këtë arsye, është vënë edhe si garanci në bankë me qëllim lëvrimin e kredisë për shlyerjen e vlerës së blerjes. Subjekti ka pretenduar se për këtë automjet, kontrata e dytë është bërë për faktin se zhdoganimi i mjetit do të bëhej mbi vlerën reale të tij, pa përfshirë këtu vlerën e transportit nga Amerika në Shqipëri, vlerë e cila ka qenë rreth 200.000 lekë, siç pasqyrohet edhe në deklaratën doganore datë 9.10.2009. Në vlerën prej 1.000.000 lekësh, që është vlera e blerjes së mjetit, është përfshirë edhe vlera e transportit të automjetit. Vlera reale e tij ka qenë 6.000 euro dhe për këtë arsye zhdoganimi është bërë mbi vlerën reale të automjetit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, datë 9.10.2009. Lehtësisht konstatohet se vlerat përkatëse përputhen. Vlera reale prej 6.000 eurosh e automjetit, me kursin e kohës ka qenë tetëqind e katër mijë lekë, plus edhe vlera e transportit të përfshirë, del vlera prej një milion lekësh, pra, vlera e blerjes së automjetit. Pala shitëse e ka shprehur vullnetin e saj, pasi kemi qenë në Kukës së bashku, ku dhe është bërë zhdoganimi i automjetit, pala shitëse ka nënshkruar kontratën e cila duket se është regjistruar më pas nga noteri”.*

Subjekti ka kundërshtuar mbi mospërputhjet e çmimit të blerjes së makinës pasi banka ka administruar pikërisht kontratën e shitblerjes së makinës me vlerën e përgjithshme të saj prej një milion lekësh. *“Banka ka dhënë kredi mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe jo mbi bazën e deklarimeve të mia. Bankës i kam paraqitur dokumentacionin e kërkuar për marrjen e kredisë për blerjen e mjetit, i cili është verifikuar nga ana e saj dhe më pas është lëvruar kredia. Përcaktimi i vlerës prej 140.000 lekë në kontratën me bankën, është vënë nga kjo e fundit, dhe jo nga unë, pasi unë kam dorëzuar dokumentacionin e rregullt për lëvrimin e kredisë për blerjen e automjetit, dhe pikërisht për shkak të vlerës së saj, banka ka kërkuar si garanci edhe disa orendi shtëpiake.”*

Subjekti ka qartësuar edhe mbi pjesën takuese në këtë pasuri se është 50 % pasi është fituar pas lidhjes së martesës, duke sqaruar se pasqyrimi nga bashkëshortja e tij në pjesën takuese 100 % është gabim njerëzor, apo lapsus.

5.14 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

- Trupi gjykues në analizë të fakteve: (i) se dy kontratat janë nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit; (ii) se ky i fundit ka rënë në dijeni të këtyre akteve të ndryshme në disa elemente thelbësore; (iii) se subjekti i ka pranuar këto akte dhe ka dhënë shpjegime në deklarime për to, dhe në prapësime gjithashtu, madje duke synuar edhe të provojë legjitimitetin dhe mbetjen e tyre në fuqi, pa ndërmarrë asnjë hap ligjor për revokimin e njërës prej tyre; (iv) se ato vijojnë të jenë në fuqi; (v) se subjekti me vetëdije ka depozituar njërën kontratë në dosjen e ILDKPKI-së, por edhe me qëllim përfitimin e kredisë dhe tjetrën në dosjen e DPSHTRR-së për të qenë në pajtim me kërkesat e legjislacionit të fushës; (vi) se subjekti ka anashkaluar tërësisht dhënien e shpjegimeve mbi mosprezencën e palës shitëse në kontratën e datës 9.10.2009, akt të cilin e pretendon se është kryer për shkak të pagesës së zhdoganimit, bazuar në referencën doganore dhe vlerën reale të automjetit; (vii) se kontratat përmbajnë vlera të ndryshme monetare; çmon se gjendet përpara dy akteve noteriale, të cilët, në përmbajtje të tyre përmbajnë elemente fiktive dhe për pasojë secila prej tyre rezulton të jetë fiktive.

- Gjithashtu, trupit gjykues i rezulton se kontrata e datës 3.10.2009, e noterizuar në prani të palëve kontraktore me vlerën 1.000.000 lekë, është nënshkruar për këtë automjet, në një kohë që ai/automjeti ende nuk kishte hyrë në territorin e vendit tonë, pasi sipas deklaratës doganore, destinacioni i tij në Morinë daton një javë pas nënshkrimit të kontratës (datë 9.10.2009). Pra,

lidhur me kontratën e datës 3.10.2009, trupit gjykues i rezulton se kemi të bëjmë me një kontratë pa objekt. Ndërsa, kontrata e datës 9.10.2009 nga njëra anë bën pronare njërën palë, por nga ana tjetër mungon pala shitëse, pasi rezultoi të kishte udhëtuar jashtë vendit një ditë më parë. Në këtë rast rezulton se mungon vullneti dhe nënshkrimi i palës shitëse.

- Në lidhje me pretendimin e subjektit se lehtësisht konstatohet se vlerat për blerjen e këtij automjeti përputhen, trupit gjykues i rezulton se pretendimi nuk qëndron dhe se ai mbetet në nivel deklarativ, pasi kontratat qartësisht pasqyrojnë vlera të ndryshme. Përlllogaritjet që kërkon të bëjë subjekti për t'i trajtuar vlerat të barabarta janë të njëanshme dhe nuk përputhen, pasi duke përfshirë vlerën e pretenduar të transportit me të cilën ai kërkon të përafrojë vlerat kontraktore, por edhe atë të zhdoganimit, të cilën në fakt ai e anashkalon, vërehet se shuma e përlllogaritur nuk përputhet as edhe me vlerën e përfituar nga kredimarrja.

- Trupit gjykues në lidhje me deklaratimet e pjesëve takuese të këtij automjeti i rezulton se shpjegimi i subjektit është bindës dhe se konstatimi vlerësohet si një pasaktësi në deklaram.

-Bazuar në provat e administruara, arsyetimin ligjor, trupi gjykues çmon se pavarësisht se këto dy kontrata janë nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit, ky i fundit në dijeni të plotë, i ka përdorur ato si dokument provues në deklaratën për Veting, po ashtu edhe në DPSHTRR, veprime të cilat dëshmojnë sjellje që cenojnë etikën e magjistratit.

6. Në lidhje me deklaramin gjendje *cash* nga kursimet familjare, në vlerën 200.000 lekë, në pjesë takuese 50 %.

- ✓ Komisioni kreu hetim lidhur me mundësinë e krijimit të kësaj shume dhe bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti ka pasur mundësi për krijimin e gjendjes *cash* në shumën e deklaruar në vitin 2016.

7. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, shumë e krijuar nga pagat si prokuror deri ditën e deklarimit, në shumën 107.000 lekë, me burim krijimi sipas deklaratës “Vetting”: pagat si prokuror deri ditën e deklarimit.

7.1 Në raportin e saj ILDKPKI-ja është shprehur se subjekti ka deklaruar llogari me gjendje 107.000 lekë, kurse “Raiffeisen Bank” konfirmon llogari me balancë më të ulët se ajo e deklaruar.

7.2 Nga hetimi i kryer nga Komisioni është konstatuar se “Raiffeisen Bank”²³ ka konfirmuar ekzistencën e një tjetër shume nga ajo e deklaruar nga subjekti dhe konkretisht, 32,044.46 lekë dhe për këtë mospërputhje i është kërkuar subjektit të japë shpjegime.

7.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti në shpjegimet e tij ka deklaruar se të dhënat i ka marrë pikërisht nga kjo bankë, se gjendja e llogarisë është pakësuar nga tërheqjet që kishte bërë në shuma të ndryshme, në kohë të ndryshme, dhe për pasojë ka shjeguuar se ai mund të jetë thjesht një mosrarakordim i bankës, pasi ajo ka qenë llogari rrjedhëse nga paga.

-Trupi gjykues bazuar në shpjegimet e subjektit, çmon se ato provohen dhe janë bindëse.

²³ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 19.4.2018, në dosjen e Komisionit.

8. Overdraft në vlerën 200.000 lekë, me afat maturimi 24 muaj, në “Credins Bank”, dega Kukës. Shuma e detyrimit financiar: në vlerën 208.694, 25 lekë.

8.1 Komisioni hetoi mbi këtë deklaram të subjektit nga ku i rezultoi se “Credins Bank”²⁴ ka konfirmuar marrëveshje huaje në llogari rrjedhëse Overdraft në shumën 220.000 lekë.

-Trupi gjykues, bazuar në vërtetësinë e konfirmimit bankar, çmon se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin.

9. Në lidhje me adresën e banimit të subjektit në Tiranë

9.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

9.2. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se ishte regjistruar në Gjendjen Civile, Njësia Administrative nr. 2, Tiranë dhe adresë vendbanimi: Lagjja “A. D.”, rruga “I. D.”, rugica “Zh.”, pallati D., Tiranë dhe “vendqëndrim tjetër adresë e plotë ku banoni”: “Lagjja nr. (***) , p. (***) , shk. (***) , ap. (***) , Kukës”.

9.3 Në deklaratën vjetore periodike 2010 subjekti kishte deklaruar se ishte regjistruar në Gjendjen Civile, Njësia Administrative nr. 2, Rruga “I. D.”, Tiranë dhe “vendqëndrim tjetër adresë e plotë ku banoni”: “Lagjja nr. (***) , pallati (***) , Kukës”.

9.4 Në pyetësorin nr. 1 subjekti ka deklaruar si adresë banimi: Rr. “T. Sh.”, Njësia Administrative nr. 1, Tiranë, ndryshuar emërtimi në: Rr. “T. T.” nr. (***) , hyrja (***) , ap. (***) , Njësia Administrative nr. 1, ndërsa adresa në zyrat e gjendjes civile është: Njësia Administrative nr. 2, Rruga “T. Sh.”, Tiranë.

9.5 Në pyetësorin nr. 1 subjekti ka deklaruar se nga viti 2011 e në vijim ka jetuar në këtë apartament, ndërkohë, nga vërtetimi hipotekor i këtij apartamenti rezulton se në datën 12.4.2012 ka kaluar në pronësi të pronarit aktual.

9.6 Subjekti kishte deklaruar banimin me qira në këtë apartament për vitet 2013²⁵, 2014, 2015 dhe në vijim.

9.7 Subjekti e kishte deklaruar për herë të parë si adresë banimi këtë apartament në vitin 2010.

9.8 Komisioni, me pyetësorin datë 25.2.2019, ka kërkuar që subjekti të deklaronte se ku kishte jetuar në vitet 2006 – 2013, si dhe të deklaronte marrëdhënien që kishte pasur me adresën/at e banimit, të mbështetur në dokumentacion ligjor.

9.9 Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka deklaruar se: *“... nga viti 2006 deri në muajin shtator të vitit 2010, unë më familjen time kemi jetuar në Kukës. Nga tetori 2010, deri në mars të vitit 2011, djali im, G. C., ka jetuar në shtëpinë e kunatës tuaj. Në mars të vitit 2011, shoku im z. D. B., më ka dhënë pa qira apartamentin ku sot banoj aktualisht me qira.”*

9.10 Komisioni ka vlerësuar se përdorimi i apartamentit pa qira, ka favorizuar subjektin në krijimin e kursimeve në vitet 2011 dhe 2012.

9.11 Komisionit, nga analiza e deklaramëve të subjektit, i ka rezultuar se: - ka mospërputhje midis deklaramit të bërë nga subjekti gjatë hetimit administrativ, se përdor këtë apartament prej vitit 2011 dhe deklaramit në deklaratën periodike të vitit 2010 ku deklaroi “se është regjistruar në Gjendjen Civile, Njësia Administrative nr. 2, Rruga ‘I. D.’, Tiranë”; - se, dukej se kishte

²⁴ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 16.8.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁵ Noteri public, znj. Sh. Gj. me shkresën datë 4.3.2019 ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e qirasë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 23.3.2013.

përdorur këtë pasuri pa paguar qira për dy vite radhazi, përkatësisht në vitin 2011 dhe 2012, në kushte preferenciale, me pasojë krijimin e kursimeve në favorin e tij dhe për këto i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

9.12 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar se deklaratimet e tij në lidhje me adresat e banimit dhe të qëndrimit kanë qenë në çdo rast të vërteta, siç ka qenë gjendja reale dhe faktike; se adresën: Rr. "I. D.", Njësia Nr.2, Tiranë, e ka deklaruar si adresë regjistrimi dhe jo si adresë vendbanimi apo qëndrimi, më tej ka cituar " ... është e vërtetë që familja ime dhe më pas unë, nga viti 2012 ... kam qëndruar në apartamentin ku banoj sot me qira, që nga marsi i vitit 2011, pasi që atëherë dhe më përpara, pra që në vitin 2010, kur është regjistruar në emër të shoqërisë në hipotekë, e ka disponuar këtë apartament shtetasi D. B., sipas kontratës së sipërmarrjes që kishte bërë me shoqërinë, ka marrë në dorëzim çelësat e apartamentit, ku edhe kontrata e energjisë elektrike është lidhur që në atë kohë në emër të tij, pra në vitin 2007, pavarësisht se kalimi i pronësisë në hipotekë është bërë me datë 12.4.2012, dhe këtu nuk ka asnjë mospërputhje. Në asnjë deklaratë timen nuk kam deklaruar këtë apartament, si adresë banimi që në vitin 2010. Konstatimi se përdorimi i këtij apartamenti pa qira, më ka favorizuar në krijimin e kursimeve në vitet 2011 dhe 2012, në favorin tim, nuk qëndron. Unë përgjatë vitit 2011 dhe deri në prill 2012, kam qëndruar në Kukës, pasi aty isha me punë, siç kam shpjeguar edhe më parë. Në Tiranë, qëndronte bashkëshortja me djalin e mitur, i cili ishte në shkollë. Vajtje-ardhjet nga Tirana në Kukës dhe anasjelltas, për të qenë bashkë gjatë asaj periudhe, nuk më kanë favorizuar aspak në kursime, por më kanë kushtuar, e për rrjedhojë nuk kam pasur mundësi të kursej e të deklaroj kursimet... çfarë kursimesh kisha unë, kur bashkëshortja ime për periudhën tetor 2010, mars 2011, ishte e papunë."

✓ Trupi gjykues në lidhje me këtë çështje, çmon se shpjegimet e subjektit duken bindëse.

10. Në lidhje me krijimin e të ardhurave të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie nga shtetasi D. B.

10.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

10.2 Për të sqaruar situatën në lidhje me faktin se cili ka qenë pronari fillestar i këtij apartamenti, Komisioni i ka kërkuar informacion ZVRPP-së Tiranë.

10.3 Nga përgjigjja e ZVRPP-së²⁶ Tiranë rezulton se ky apartament ka qenë i regjistruar në emër të shoqërisë "D." sh.p.k., prej datës 8.6.2010 me nr. regjistri (***), bazuar në vërtetimin hipotekor të datës 25.10.2011.

10.4 Në datën 17.2.2012 rezulton se me kontratën e shitjes nr. (***), z. D. B. ka blerë këtë apartament për shumën 58.500 euro, i ndodhur në katin e parë me nr. 13 dhe sipërfaqe 87.2 m².

10.5 Ka rezultuar se z. D. B. ka porositur këtë apartament (2+1), me kontratën e porosisë me nr(***).rep., nr. (***) kol., datë 21.4.2007, (pasuri të cilin subjekti e ka deklaruar se banon me qira) dhe se ka parapaguar këstin e parë në shumën 47.500 euro në këtë datë. Në këtë kontratë, në fund të nenit 7 është cituar shprehimisht: "Palët deklarojnë se kontrata e sipërmarrjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.3.2006 lidhur midis "D." sh.p.k., dhe D. B., shfuqizohet, palët i kanë shlyer detyrimet karshi njëri-tjetrit (pasi sipërmarrësi ia ka kthyer porositësit të gjithë kështet e paguara prej tij)."

²⁶ Nr. (***) prot., datë 26.12.2018, në dosjen e Komisionit.

10.6 Nga korrespondenca bankare me “Intesa Sanpaolo Bank”²⁷ në emër të z. B. rezulton një transaksion bankar në vlerën 10.303,82 dollarë. Në datën 6.7.2006, po në këtë bankë, rezulton se në emër të z. B. është disbursuar kredi në shumën 1.800.000 lekë.

10.7 Nga korrespondenca bankare me “BKT”²⁸, në emër të z. B. rezulton derdhje në llogarinë e tij në datën 20.12.2006, në shumën 700.000 lekë, e cila më pas është tërhequr në datën 19.2.2007. Gjithashtu, po në datën 20.12.2006 rezulton se z. B. ka derdhur shumën 3.500 euro të cilën e ka tërhequr po në datën 19.2.2007.

10.8 Nga korrespondenca bankare me “Raiffeisen Bank”²⁹ në emër të z. B. rezultojnë derdhje *cash* si dhe tërheqje në periudha të ndryshme, por pa dhënë detaje/përshkrime.

10.9 ISSH³⁰, lidhur me të ardhurat e përfituara nga z. B., disponon të dhëna për derdhjen e kontributeve nga viti 2012 e në vijim.

10.10 Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë³¹ ka informuar se shtetasi B. kryen deklarime individuale nga viti 2015 e në vijim (deri 2018) për pagesën e tatimit në burim (të ardhura nga qiraja).

10.11 ZVRPP³² ka konfirmuar katër pasuri në bashkëpronësi edhe me shtetasin B., të ndodhura në z.k. (***): një pasuri po në këtë z.k. e cila figuron në emër të tij, si dhe këtë pasuri objekt hetimi administrativ.

10.12 Z. B. rezulton të ketë qenë subjekt deklarimi dhe për pasojë janë verifikuar deklaratat vjetore periodike e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja³³, nga ku rezultoi se ai ka qenë subjekt i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar prej vitit 2008 – 2010.

10.13 Në deklaratën vjetore periodike për vitin 2008 para fillimit të detyrës, shtetasi B. ka deklaruar këtë pasuri me burim krijimi: emigracion, kredi bankare, të ardhura familjare, hua tek të afërmit e tij (vëllezër dhe motra).

10.14 Komisioni ka pyetur³⁴ subjektin lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti nga shtetasi D. B., lidhur me marrëdhënien që ai ka me këtë shtetas, lidhur me faktin se kur e ka marrë për herë të parë me qira apartamentin e z. D. B., se kur është bërë pronar i këtij apartamenti ky shtetas, dhe nëse ky apartament është i njëjtë me apartamentin që i kishte blerë këtij shtetasi.

10.15 Në përgjigjen³⁵ e dhënë subjekti ka deklaruar të njëjtin burim krijimi të kësaj pasurie siç ka deklaruar shtetasi B. në deklaratën vjetore periodike 2008 para fillimit të detyrës.

10.16 Komisionit, nga analiza e fakteve, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe deklaratimet nga subjekti, i rezultoi se dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit të shumës së përdorur për porosinë/blerjen e kësaj pasurie dhe për këtë i kaloi subjektit barrën e provës.

²⁷ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 19.2.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 21.2.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 12.2.2019.

³⁰ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 11.2.2019, në dosjen e Komisionit.

³¹ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 21.12.2019

³² Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 20.8.2019, në dosjen e Komisionit.

³³ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 18.2.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Referojuni pyetësorit datë 5.2.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁵ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit datë 5.2.2019, në dosjen e Komisionit.

10.17 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në prapësimet e tij ka pretenduar se shtetasi D. B., në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është person i lidhur me të, ndërsa ka shpjeguar se z. B. ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se z. B. ka pasur disa depozita bankare, ka punuar si avokat në vitet 2005 – 2006, ka punuar në emigracion pas viteve ‘90, që në vitin 1993 ka pasur biznes familjar, lokal, i regjistruar si person fizik, etj. Subjekti ka depozituar edhe disa dokumente bankare, mandatpagesa, etj.

10.18 Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

- Trupi gjykues në analizë të fakteve se subjekti i rivlerësimit i) ka deklaruar këtë pasuri si adresë të gjendjes civile prej viti 2010, ii) si adresë banimi prej vitit 2011, iii) ka pohuar se në vitin 2011 dhe 2012 ka përdorur këtë pasuri me qira pa kundërshtim, çka nënkupton se ka hyrë në një marrëdhënie interesi pasuror, çmon se shtetasi D. B. përfshihet në rrethin e personave të tjerë të lidhur, bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe pikën 4 të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe për pasojë subjekti kishte detyrimin të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

Trupit gjykues në analizë të deklarimit të subjektit mbi burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie nga shtetasi B., duke sqaruar se ato ishin krijuar me burim emigracioni, kredi bankare, të ardhura familjare, hua tek të afërmit e tij (vëllezër dhe motra), i rezultoi se i) për të gjitha transaksionet bankare kryesisht derdhjet në llogari të shtetasit D. B., nuk kishte përshkrim për të kuptuar burimin e këtyre të ardhurave nga emigracioni, sikurse subjekti pretendonte, ii) kredia e përfituar në shumën 1 800 000 lekë nuk provohej nëse kishte shkuar me destinacion shlyerjen e kësaj pasurie, për shkak se mandat pagesa e derdhjes së shumës 17 000 euro rezultonte të ishte pa datë dhe se kjo shumë nuk përputhej në vlerë monetare me shumën e marrë kredi, iii) QKB³⁶ në informacionin e saj konfirmoi se shtetasi D. B. figuron i rregjistruar si person fizik, me Vendimin Nr.17557 datë 06.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Tiranë për të cilin nuk gjendet NIPT, iii) se DPT³⁷ informoi se shtetasi B. nuk figuron i rregjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat, iv) subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë për të provuar huatë e marra nga shtetasi B. për shlyerjen e pagesave të kësaj pasurie.

Për sa sipër, në analizë të dokumenteve të administruara gjatë hetimit administrativ nga institucionet bankare por edhe atyre të depozituara nga subjekti, Trupi Gjykues arrin në konkluzion, se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe provojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur në kohën e blerjes së këtij apartamenti, pasuri që subjekti i rivlerësimit ka përdorur dhe përdor aktualisht me qira.

- Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit.

11. Autoveturë, tip “Opel Corsa C14”, benzinë, me targë AA (*)**, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 23.2.2014, Durrës. Vlera 500 euro + 18.256 lekë - zhdoganuar. Pjesa takuese 50%, në përdorim nga bashkëshortja.

Burim i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kursimet familjare.

³⁶ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 18.02.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁷ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 18.02.2019, në dosjen e Komisionit

11.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së.

11.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

11.3 Kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën vjetore periodike të vitit 2014.

11.4 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2015 me burim krijimi: kursimet familjare.

11.5 DPSHTRR-ja me shkresën nr. (***) prot., datë 4.5.2018, ka konfirmuar ekzistencën e këtij automjeti në emrin e personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, znj. A. C. . Bashkëshortja e subjektit këtë automjet e ka blerë nga shtetasit M. Sh. dhe L. U. në shumën 500 euro me kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 23.2.2014.

11.6. Sipas deklaratës doganore, (***) datë 27.2.2014, zhdoganimi i këtij automjeti është në vlerën 24.212 lekë dhe jo në vlerën 18.256 lekë, sikurse është deklaruar në deklaratën “Vetting”. Vlera e kësaj pasurie është 94.267 lekë.

11.7 Lidhur me aftësinë paguese të këtij automjeti, Komisioni kreu analizën financiare³⁸, si më poshtë.

Tabela nr. 3

| Analizë financiare - viti 2014 | |
|---|------------------|
| Pasuri | 106,775 |
| Automjet, tip “Opel Corsa C14”, targë (***) datë 23.2.2014 | 94,267 |
| Diferencë likuiditeti | 12,508 |
| Detyrime | (427,193) |
| Kredi për blerje apartamenti në “BKT”, vlera 1.000.000 lekë (7.8.2006) | -126,299 |
| Kredi për shlyerje automjeti “Credins Bank”, vlera 1.200.000 lekë (9.11.2009) | -300,894 |
| PASURI NETO (PASURI - DETYRIME) | 533,968 |
| Të ardhura të dokumentuara | 1,442,804 |
| Të ardhura të dokumentuara - subjekti | 1,312,014 |
| Të ardhura të dokumentuara - bashkëshortja e subjektit | 130,790 |
| Shpenzime | 1,810,886 |
| Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së | 881,520 |
| Qira, kontrata datë 23.3.2013, banesa lagjja: “A. D.” (15.000 lekë) | 180,000 |
| Shpenzime arredimi ap. me qira në Tiranë | 200,000 |
| Pagesë energji elektrike për periudhën 2007 – 2014 | 480,000 |
| Interesa - kredia “Credins Bank” (1.200.000 lekë) | 30,145 |

³⁸ Referojuni treguesve sipas dokumentacionit, në “BKT”, datë 7.8.2006 (kredi për blerje apartamenti në vlerën 1.000.000 lekë); në “Credins Bank”, në datën 9.11.2009 (kredi për blerje makine në vlerën 1.200.000 lekë).

Të ardhurat për vitin 2014 pasqyrohen sipas shkresave, në dosjen e ILDKPKI-së: vërtetim i Prokurorisë pranë Gjykatës Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin mbi të ardhurat e subjektit në shumën 1.331.248 lekë. Për bashkëshorten e subjektit nuk kanë rezultuar të ardhura. Sipas dokumentacionit të administruar pranë Komisionit, të ardhurat rezultojnë: në bazë të *statement-it* bankar të “Raiffeisen Bank”, përcjellë me shkresën nr. (***) prot., datë 19.4.2018, të ardhurat e subjektit janë 1.312.014 lekë. Në bazë të *statement-it* bankar të “Credins Bank”, përcjellë me shkresën nr. (***) prot., datë 16.8.2018, të ardhurat e bashkëshortes së subjektit janë 130.790 lekë. Shpenzimet për vitin 2014 përfshijnë: shpenzimet e jetesës në shumën 881.520 lekë, sipas raportit të ILDKPKI-së dhe ndarjes për secilin vit për një familje me 4 persona; qiraja e vitit (2014) në vlerën 180.000 lekë, sipas kontratës së deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2013 me nr. (***) datë 23.3.2013, me afat 2-vjeçar; pagesë e energjisë elektrike për vitet 2007 – 2014, në vlerën 480.000 lekë, deklaruar në deklaratën vjetore periodike të vitit 2014; shpenzime interesash për kreditë e marra.

| | |
|---|------------------|
| Interesa - kredia "BKT" (1.000.000 lekë) | 39,201 |
| Likuiditete në fillim të vitit | (191,562) |
| Llogari rrjedhëse - "Raiffeisen Bank"- paga subjekti | -74,442 |
| "ProCredit Bank", djali | 8,663 |
| OVD page, vlera 200.000 lekë, 24 muaj "Credins Bank" | -125,744 |
| "Credins Bank"- bashkëshortja | -40 |
| Likuiditete në fund të vitit | (179,055) |
| Llogari rrjedhëse - "Raiffeisen Bank" - paga subjekti | -30,038 |
| "ProCredit Bank", djali | 8,878 |
| OVD page, vlera 200.000 lekë, 24 muaj, "Credins Bank" | -157,925 |
| "Credins Bank" - bashkëshortja | 30 |
| Analiza (Të ardhura dokumentuar – Pasuri neto – Shpenzime) | -902,030 |

11.8 Nga analiza e fakteve, bazuar te dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se subjekti kishte mungesë të burimeve financiare në shumën 902,030 lekë, për të justifikuar blerjen e automjetit, si dhe për të përballuar shpenzimet jetike, të qirasë, të energjisë elektrike dhe kështu e kredive të marra dhe për këtë Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës. Po ashtu Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për mospërputhjet në lidhje me deklarin e kësaj pasurie nga bashkëshortja e tij në vitin 2015, kur në fakt automjeti ishte blerë në vitin 2014 dhe për mospërputhjet në deklarin e bërë nga bashkëshortja e subjektit në shumën e deklaruar për zhdoganimin e mjetit, krahasuar me shumën e dokumentuar për t'u paguar.

11.9 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni
Subjekti ndër të tjera ka parashtruar se autovetura është blerë në datën 23.2.2014, sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) , me vlerë 500 euro, dhe me vlerë zhdoganimi 18.256 lekë; kjo pasuri, për arsye objektive është harruar të deklarohet në vitin 2014.

Lidhur me vlerën e zhdoganimit të këtij automjeti subjekti ka kundërshtuar faktin se ka rezultuar në mungesë financiare për blerjen e këtij mjeti, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera. Subjekti ka pretenduar se analiza financiare duhej të bëhej për vitin 2013 dhe jo për të gjithë vitin 2014, pasi siç vërtetohet nga dokumentacioni, autovetura është blerë në datën 23.2.2014, pra, në fillim të vitit 2014. Në vijim subjekti ka pretenduar se të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare se pagesën që ajo ka marrë sipas ligjit për barrë - lindje e ka kursyer..., etj.

11.10 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm
Trupi gjykues, pasi analizoi faktet, rrethanat, si dhe pretendimet e subjektit, të cilat kanë mbetur në nivel deklarativ, çmon se ato nuk qëndrojnë, për shkak se analiza financiare është kryer deri në momentin e blerjes së kësaj pasurie, se në të janë përfshirë, i) të ardhurat nga barrë-lindja e bashkëshortes së subjektit sipas të dhënave të dokumentacionit të institucioneve publike, administruar në dosjen e hetimit administrativ, ii) të ardhurat e subjektit të konfirmuara në nivel zyrtar, si dhe iii) gjendja e likuiditeteve, por gjithnjë duke zbritur shpenzimet e kryera, detyrimet financiare, sipas treguesve në tabelën përkatëse.

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe në shqyrtimin e rrethanave në tërësi, trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi:

- i. bazuar në analizën financiare ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie/automjet të deklaruar në deklaratën “Vetting”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera;
 - ii. pretendimet e subjektit mbi nivelin e provueshmërisë së burimit të mjaftueshëm të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera rezultuan në nivel deklarativ;
 - iii. bazuar në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën e zhdoganimit të këtij automjeti, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë për sa i përket shumës së shpenzuar për zhdoganimin e tij.
- ✓ Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë bindëse, pasi në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ.

12. Katër dynym tokë bujqësore në z.k. nr. (***) , Njësia Administrative K., Lushnjë, që i takojnë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga përpjesëtimi i pasurisë.

Burim krijimi: përfituar nga familja e O. T. (babai), në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, pasuri e paregjistruar në ZVRPP.

12.1 ZVRPP-ja Lushnjë, me shkresën nr. (***) prot., datë 11.12.2018, nuk e konfirmon këtë pasuri në emër të subjektit dhe të bashkëshortes së tij.

12.2 Bazuar në vërtetimin nr. (***) prot., datë 24.2.2016, të Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës Kolonjë, vërtetohet se familja e z. O. T. ka përfituar tokë bujqësore me sip. 23.294 m² nga zbatimi i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën” në z.k. nr. (***) . Bashkëlidhur vërtetimit është certifikata familjare e datës 24.2.2016, ku në datën 1.8.1991 në përbërjen familjare të z. O.T. ka qenë edhe bashkëshortja e subjektit.

12.3 Subjekti ka depozituar edhe një deklaratë dore të z. O. T., i cili deklaron se vajza e tij, znj. A. C., ka 4 dynym tokë, e cila është e pahipotekuar.

- ✓ Trupit gjykues nuk i rezultuan dyshime mbi ekzistencën e kësaj pasurie dhe për pasojë, çmon se deklarami i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

GJETJE TË TJERA

Gjatë hetimit administrativ, në deklaratën periodike të subjektit për vitin 2006, Komisioni krijoi dyshime mbi vërtetësinë e deklaramit lidhur me përfitimin e një kredie dhe për pasojë zgjeroi hetimin administrativ.

→ Kredia e marrë në vitin 2006

13. Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2006 rezultoi se subjekti kishte deklaruar kredi konsumatore në shumën 700,000 lekë në “Raiffeisen Bank”.

13.1 Komisioni hetoi në lidhje me këtë kredi.

13.2 Me shkresën nr. (***) prot., datë 19.4.2018, “Raiffeisen Bank” e ka konfirmuar marrjen e kësaj kredie.

13.3 Kjo kredi rezulton e shlyer në vitin 2011.

13.4 Komisioni, në lidhje me qëllimin e marrjes së kësaj kredie, e ka pyetur subjektin me pyetësorin e datës 05.02.2019.

13.5 Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar se: “...kredia e marrë në datën 2.3.2006, në shumën 700.000 lekë, ka qenë kredi personale, ku nuk kërkoheshin arsyet për marrjen e tyre, dhe me ato lekë, me sa me kujtohet kam blerë një makinë, në vitin 2006, në shumën 400.000 lekë, deklaruar në deklarinimin e pasurisë në datë 16.3.2007”.

13.6 Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2006 rezultoi se subjekti kishte deklaruar blerjen e automjetit në shumën 400,000 lekë, pa përcaktuar burimin e krijimit të saj.

13.7 Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2009 rezultoi se subjekti kishte deklaruar shlyerjen totale të kredisë me burim: “shitje e makinës së blerë në vitin 2006”.

13.8. Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2010 rezultoi se subjekti ka vijuar të deklarojë shlyerjen e kësaj kredie.

13.9 Nga analiza e fakteve dhe e deklarimeve të subjektit, Komisionit i rezultoi se deklarimi i subjektit lidhur me kohën e shlyerjes së kësaj kredie ishte i paqartë pasi: - kishte mospërputhje midis deklarinimit të tij në vitin 2009, “...se kjo kredi është shlyer me burim shitjen e automjetit”, me deklarinimet e bëra në vitin 2010 dhe 2011, shlyerja e kredisë është bërë sipas kontratës; - kishte mungesë dokumentacioni të shitblerjes së automjetit dhe paqartësi se për se ishte përdorur diferenca e kredisë dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën e provës.

13.10 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në prapësimet e tij ndër të tjera ka pretenduar se kredia është marrë me afat 5-vjeçar dhe është shlyer sipas afatit të përcaktuar nga banka. Po ashtu ai ka cituar “...në datën 31.5.2005, kisha marrë një kredi personale në shumën 400,000 lekë për nevojat e mia, ashtu siç e kam shpjeguar... kur kam deklaruar se nga shitja e makinës është shlyer kredia, kam pasur parasysh faktin se janë paguar këstet e këtyre kredive, si dhe kredia me afat 2-vjeçar e marrë në vitin 2005. Për sa i përket mungesës së dokumentacionit për makinën e blerë atëherë, ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe, për këtë arsye, nuk kam mundur ta siguroj atë për ta vënë në dispozicionin tuaj, pasi as targa e mjetit nuk më kujtohet... diferenca e kredisë, e cila nuk ishte në vlerë të madhe, është përdorur për nevoja të ndryshme të familjes, siç edhe e kam shpjeguar edhe më parë”.

13.11 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, pas analizës së deklarimeve të subjektit, praktikës së kredisë bankare dhe pretendimeve të subjektit në prapësimet e tij, arrin në konkluzion se:

- i) subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues shitblerjen e automjetit për të cilin ka deklaruar se ka marrë kredi në shumën 700,000 lekë;
- ii) subjekti nuk arriti të provojë shlyerjen e kësaj kredie me shumën e përfituar nga shitja e automjetit; dhe për pasojë,
- iii) subjekti ka kryer deklarinim të pasaktë, në lidhje me destinacionin e marrjes së kredisë, si dhe në lidhje me shlyerjen e saj me burim nga shitja e automjetit, objekt i këtij hetimi administrativ.

14. Situata financiare e subjektit – të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 2003 – 2016

Komisioni ka kryer analizën financiare dhe ka vërejtur se subjekti ka pamjaftueshmëri të ardhurash të ligjshme, për justifikimin e pasurive, si dhe për kryerjen e shpenzimeve për vitet 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, sipas përshkrimeve vijuese:

- Të ardhurat janë llogaritur në bazë të dokumenteve të punësimit të subjektit dhe bashkëshortes së tij, të dokumenteve bankare, si dhe të dokumentacionit nga shitja e automjetit të deklaruar në vitin 2009.
- Për pasuritë e subjektit, blerje automjeti dhe apartament, janë marrë për bazë deklarinimet periodike të subjektit, të dhënat bankare, si dhe kontratat noteriale.
- Shpenzimet e jetesës janë llogaritur në bazë të vlerës së përcaktuar në raportin e ILDKPKI-së dhe deklarinimin e subjektit për vitin 2006 dhe 2007.
- Për udhëtimet jashtë shtetit janë marrë të dhëna nga TIMS-i dhe për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat *lo cost* deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Ndërsa, për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.
- Për llogaritjen e shpenzimeve të arredimit³⁹ të apartamentit me qira, arredimit dhe rikonstruksionit të apartamentit në Kukës, si dhe shlyerjes së energjisë elektrike janë marrë për bazë vlerat e deklaruara nga subjekti në deklarinimet periodike dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar.
- Për shpenzimet e qirasë të deklaruara në vitet 2013 – 2016 janë marrë në konsideratë deklarinimet e subjektit, si dhe akti noterial/kontratë qiraje e vitit 2013 dhe 2015.
- Për shpenzimet e subjektit për shlyerjen e interesave të kredive të marrë janë marrë për bazë dokumentet bankare.
- Për detyrimet janë marrë për bazë deklarinimet periodike, si dhe dokumentet bankare për shlyerjen e kredive.
- Për likuiditetet janë marrë për bazë deklarinimet periodike dhe dokumentacioni bankar.

Komisionit nga analiza financiare i rezultoi se për vitet 2006, 2011, 2013, 2014, 2015, subjekti ka pasur pamjaftueshmëri të mbulimit të pasurisë dhe të shpenzimeve nga burimet financiare të deklaruara dhe të dokumentuara, në vlerën 3,880,003 lekë dhe për pasojë i kaloi barrën e provës.

14.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në prapësimet e tij, ndër të tjera ka cituar... *se rezultatet e analizës financiare janë kryer mbi baza statistikore dhe jo mbi baza dokumentare. “Për vitin 2006, në këtë analizë financiare është përlllogaritur një vlerë e përcaktuar në aktmarrëveshjen me premtim shitje pasurie e vitit 2006, në kundërshtim me ligjin, pasi kjo aktmarrëveshje, siç e kam shpjeguar edhe më parë gjatë komunikimeve me ju, nuk ka prodhuar asnjë efekt... nuk kam paguar asnjë kësht për blerje të kësaj pasurie.”* Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare nuk janë marrë parasysh shpenzimet reale të jetesës, të cilat kanë qenë më të ulëta për shkak të jetesës modeste.

Po ashtu, subjekti ka pretenduar se nuk janë marrë parasysh shpenzimet reale të TIMS-it, kur udhëtimet bëheshin me oferta dhe me kursimet e mbledhura. Ai ka cituar “...nuk më janë kërkuar shpjegime, pasi për pagesën e energjisë elektrike në shumën 480.000 lekë kemi marrë borxhe të vogla te prindërit tanë, nuk është marrë parasysh fakti se shpenzimet për mobilimin e shtëpisë janë kryer edhe me këste etj.”

³⁹ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit datë 25.2.2019 në dosjen e Komisionit.

14.2 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në tërësi të analizimit të dokumentacionit provues, të deklarimeve të subjektit, të prapësimeve të cilat konsistuan në nivel deklarativ dhe jo në nivel provueshmërie, arrin në konkluzion se:

- Analiza e kryer është mbështetur në deklaratimet e subjektit dhe se ai nuk arriti të provojë të kundërtën. Subjekti ka pretenduar për mospërfshirjen e një shpërblimi të lejes së barrëlindjes të bashkëshortes, e ardhur që në fakt ishte përfshirë.

- Shuma 400,000 lekë, e shpenzuar për pagimin e energjisë elektrike, është përlogaritur sipas deklaratimit të subjektit, i cili është pyetur dhe ka pasur mundësinë të deklarojë burimin e ligjshëm të saj. Pretendimi se e ka paguar atë me hua të marrë prindërve të tij është i papranueshëm, kur ky fakt citohet vetëm në prapësime, me qëllim shmangien nga vërtetësia e deklaratimit për të ndikuar në ndryshimin e analizës financiare. Gjithashtu, lidhur me këtë pretendim subjekti nuk depozitoi asnjë dokumentacion justifikues.

- Po ashtu, pretendimi i subjektit se nuk janë marrë në analizë kursimet e mbledhura, nuk qëndron, për shkak se vetë ai në deklaratimet e tij, në pikën 9 (më sipër), ndër të tjera ka cituar: *“...nuk është favorizuar aspak në kursime ...e, për rrjedhojë, nuk ka pasur mundësi të kursente e të deklaronte kursime...”* duke cituar më specifikisht *“...çfarë kursimesh kisha unë, kur bashkëshortja ime për periudhën tetor 2010 – mars 2011 ishte e papunë.”*

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe në shqyrtimin e rrethanave në tërësi, trupi gjykues, arrin në konkluzion, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi:

- i. bazuar në analizën financiare ka pamjaftueshmëri të mbulimit të pasurisë dhe të shpenzimeve të kryera me burimet financiare të deklaruara dhe të dokumentuara, në vlerën 3,880,003 lekë;
 - ii. pretendimet e subjektit mbi nivelin e provueshmërisë së burimit të mjaftueshëm të të ardhurave për blerjen e pasurisë dhe për shpenzimet e kryera rezultuan në nivel deklarativ.
- ✓ Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë bindëse, pasi në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ.

B. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hartuar raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit⁴⁰. Ky raport është bazuar: në formularin e vetëdeklarimit; në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; në 5 dosjet hetimore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; në të dhënat nga burimet arkivore të prokurorisë. Nga analiza e Këshillit të Lartë i Prokurorisë për dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga analizimi i të dhënave në 8 dosjet, referuar në neneve 71 – 76 të ligjit të statusit për kriteret e vlerësimit, ky institucion për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit ka parashtuar se:

⁴⁰ Referojuni shkresës nr. (***)prot., datë 13.5.2019.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Përgjithësisht subjekti i rivlerësimit, prokurori Shkëlzen Cena, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në të tria aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në të pesta dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti përgjithësisht ka identifikuar drejt normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Përgjithësisht, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo me rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe të urdhrin nr. (***) , datë 5.9.2003, *“Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”* të Prokurorit të Përgjithshëm. Aktet e përpiluara prej tij janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrin.

Nuk evidentohen të dhëna nëse qëndrimet e prokurorit në të gjitha rastet janë mbështetur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin (duke qenë se mungojnë vendimet e kësaj gjykate).

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, përgjithësisht shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, në disa akte ka përdorur *“dialektizma”*, por përgjithësisht ka respektuar rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej tij. Aktet e përpiluara janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e akteve procedurale rezulton se formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Rezulton se konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe në argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf. Subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior dhe cilësor në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe të kërkesave të ndryshme penale, prokurori Shkëlzen Cena, ka përballuar ngarkesën e punës, me eficensë në hartimin e akteve procedurale. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit përgjithësisht është i organizuar, eficient dhe efektiv. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, përgjithësisht është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

Gjatë analizimit të këtij raporti Komisioni ka konstatuar, sikurse edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, disa problematika në një prej dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në tre dosjet, që i përkasin pesë dosjeve të përzgjedhura me short.

Komisioni ka konstatuar se:

1. Në dokumentin, Diskutimin përfundimtar, *Mbi procedimin penal, nr. (***)*, të vitit 2012, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në pjesën konkluduese të tij, nuk rezultonte të ishin shpjeguar arsyet se përse diskutimi përfundimtar ishte zhvilluar para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që procedimi penal ishte hetuar nga Prokuroria Kurbin, si dhe lidhur me transferimin i çështjes në një tjetër gjykatë nga ajo që i përkiste organit të prokurorisë që kishte kryer hetimin e çështjes. Për këtë Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti ka shpjeguar se këtë fakt ua ka bërë me dije palëve, që në çelje të shqyrtimit gjyqësor dhe se transferimi i çështjes dhe përcaktimi i gjykatës së shqyrtimit të çështjes, ishte vendosur nga Gjykata e Lartë, me kërkesë të të pandehurve, dhe se subjekti ishte autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm për të përfaqësuar akuzën në gjykatë.

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues në analizë të fakteve: (i) se në diskutimin përfundimtar subjekti nuk ka qartësuar arsyen se përse përfaqësonte organin e akuzës në një tjetër gjykatë nga ajo ku ishin kryer hetimet; (ii) se subjekti nuk depozitoi prova për të provuar se transferimi ishte kryer me kërkesë të të pandehurve, si dhe ishte autorizuar nga prokurori, çmon se subjekti faktet e mësipërme, duhet t'i kishte arsyetuar në mënyrë të plotë e të qartë.

2. Në procedimin penal nr. (***)/2015, për veprën penale “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit, ndër të tjera është vërejtur se në arsyetimin e

vendimit nuk evidentohet mënyra se si subjekti ka arritur të vendosë pushimin e çështjes; nuk pasqyroheshin në vendim veprimet hetimore në vijimësi; dhe nuk përputhej me veprën penale për të cilën prokurori kishte urdhëruar regjistrimin e procedimit penal; nuk kishte bërë analizë të figurës së veprës penale; dhe nuk kishte dhënë arsyen se përse kemi të bëjmë me dy vepra penale “*të përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike*” dhe “*të fyerjes*” nëpërmjet telefonit; nuk kishte arsyetuar në vendim se përse kemi të bëjmë me konkurrin të dy veprave penale, ndërkohë që nuk përkon baza ligjore e përdorur; dhe për këto i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Në prapësimet e tij subjekti ka sqaruar se kjo vepër penale ndiqet me ankim të të dëmtuarit, i cili në çdo fazë mund të kërkojë heqjen dorë nga e drejta e ankimit apo tërheqjen e ankimit sipas nenit 284 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, siç ka ndodhur edhe në rastin konkret. Prandaj në vendimin e pushimit është cituar baza ligjore, germa “c”, e nenit 328.1, e Kodit të Procedurës Penale, kur i dëmtuari heq dorë nga e drejta e ankimit. Subjekti pretendon se kur kallëzuesi heq dorë nga ankimi për veprën penale, vlerësohet se nuk është i nevojshëm analizimi i gjatë i elementeve të faktit, të figurave, të veprave penale etj., pasi procedimi nuk mund të vazhdojë.

Subjekti pretendon se gjatë fazës verifikuese të kallëzimit, ligji dhe urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nuk parashikonin kryerjen e veprimeve të mirëfillta procedurale. Subjekti ka depozituar vendimin nr. 39, datë 23.6.2000, të Gjykatës Kushtetuese për fillimin e ndjekjes penale nga gjykata.

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues pas analizimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, çmon se ai: (i) në prapësimet e tij shprehet sikundër duhet të kishte vepruar kur ka arsyetuar vendimin, pra, duhet të kishte arsyetuar gjerësisht se si kishte arritur në vendimin e pushimit, gjë të cilën në fakt rezulton se nuk e ka bërë; ii) duhet të analizonte veprimet që janë ndërmarrë prej tij deri në momentin e heqjes dorë nga e drejta e ankimit; (iii) gjatë arsyetimit nuk ka argumentuar për veprën penale të shtuar të fyerjes, pasi procedimi penal është regjistruar vetëm për veprën penale “*Përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike*”; (iv) nuk ka pasqyruar parashikimet ligjore të ligjit dhe urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe vendimin e Gjykatës së Lartë që ka depozituar dhe, për pasojë, ashtu sikurse është shprehur në raportin e tij Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mangësitë në arsyetimin e vendimit qëndrojnë.

3. Në procedimin penal nr. (***) të vitit 2015 për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të cilën subjekti ka vendosur: *pushimin e procedimit penal*, në vendim rezulton se argumentohet fakti se nuk dihet koha e kryerjes së veprës penale, ndërsa procedimi është pushuar pikërisht për shkak të *ligjit të kohës “Për dhënie amnistie”*. *Sipas këtij ligji është amnistuar ndjekja penale për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” për të gjitha ndërtimet e bëra pa leje deri më datën 10 prill 2014.*

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti ndër të tjera pretendon se procedimi është pushuar për shkak se fakti i konstatuar në datën 24.7.2015 nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në germën “b”, të nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, dhe jo për shkak të ligjit nr. 92/2015. Ndër të tjera subjekti ka cituar, *Në pjesën konstatuese të vendimit është evidentuar fakti se për ndërtimin e shtesës me sip. 22 m² të lokalit, nuk mund të bëhet ndjekje penale për “ndërtim të paligjshëm”, bazuar në nenin 4, të Kodit të Procedurës Penale, dhe ligjeve nr. 22/2014 dhe nr. 92/2015, dhe jo për faktin e konstatuar në datën 24.7.2015, për të cilin ishte referuar materiali kallëzues, vendosja*

e vetratave prej duralumini dhe riparimi i fasadës së lokalit. Pikërisht për këtë fakt është vendosur pushimi i procedimit, pasi vendosjet e dyerve dhe të dritareve, punimet për riparim fasade objekti, vendosjet reklamash etj., janë përjashtuar nga leja e ndërtimit. Në vendim është evidentuar mënyra se pse është arritur në konkluzionin se vendosja e vetratës prej duralumini (xham), si punim, nuk hyn në kategorinë e punimeve apo të ndërtimeve që kërkojnë leje ndërtimi, bazuar pikërisht në neni 6 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, ku thuhet se ndërhyrjet si riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe i dyerve, i qepenave dhe i vitrinave etj., bëhen pa kërkuar leje ndërtimi. Në argumentim sa më sipër, rezulton se prokurori ka vendosur bazuar në rrethanat e faktit, në provat dhe në ligjin dhe aktet nënligjore, duke e zgjidhur çështjen në mënyrë të drejtë e ligjore.

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues vlerëson se subjekti me pretendimet e tij nuk provon të kundërtën, pasi ligji nr. 92/2015, “Për dhënie amnistie”, i cili ka ndryshuar ligjin nr. 22/2014, në nenin 2 ka parashikuar: “Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale në fjalë është kryer jo më vonë se data 10 prill 2014”. Subjekti në arsyetim të vendimit ka përdorur ligjin për amnistinë, ndërsa bën pushimin e çështjes, se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Arsyetimi i vendimit nuk përkon me dispozitivin. Procedimi është regjistruar në datën 29.7.2015 dhe ka përfunduar në datën 2.12.2015. Nuk provohet nëse ndërtimi pa leje po kryhej apo ishte kryer më parë. Subjekti është shprehur vetëm mbi bazën e fotove në vendimin e pushimit. Përdorimi i kësaj baze ligjore detyronte subjektin e rivlerësimit të thellohej në arsyetim mbi kohën e kryerjes së ndërtimit të paligjshëm, për shkak se kallëzimi i referohej ndërtimit të paligjshëm të një shtese, ndërsa subjekti e anashkalon arsyetimin vetëm për disa punime vetratash, për të cilët në fakt shprehet qartë ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

- Trupi gjykues vlerëson se në këtë çështje, në vendimarrjen e saj, nga subjekti i rivlerësimit është anashkaluar arsyetimi i plotë, i duhur dhe ligjor, për më tepër kur diskutohet edhe mbi një ligj specifik “Për dhënie Amnistie”, nga i cili kërkohen afate dhe vlerësime.

4. Në procedimin penal nr. (***)/2014, me të pandehur shtetasin N. R., i akuzuar për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, për të cilën subjekti ka kërkuar deklarinim fajtor të këtij të pandehuri, si dhe dënimin e tij me gjobë, në konkluzionet përfundimtare rezulton se nuk janë analizuar elementet e veprës penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”.

- Në prapsimet e tij mbi këtë konstatim, subjekti ndër të tjera duket se ka pranuar faktin se ka arsyetuar në mënyrë sipërfaqësore, duke shpjeguar se ka bërë një analizë të thjeshtë të elementeve të veprës penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, për shkak se në atë kohë ka cituar ai, *ngarkesa e punës ka qenë tepër e madhe dhe ka qenë i ngarkuar edhe me detyrën e prokurorit të ekzekutimit të vendimeve penale.*

- Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë argumente justifikuese, pasi ato cenojnë arsyetimin e plotë dhe të kuptueshëm të një akti përfaqësimi të akuzës/konkluzionit përfundimtar.

➔ Nga analizimi i të dhënave nga burimet arkivore pasqyruar në raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit me urdhrin nr. (***), datë 2.6.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, kishte marrë masën disiplinore “*vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra*”, në kohën kur ai ushtronte funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës,

për shkak të moskryerjes së disa veprimeve hetimore në një procedim penal të vitit 2003. Për këtë informacion Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime.

- Subjekti në prapsimet e tij, ndër të tjera ka shpjeguar se materiali kallëzues nga policia për çështjen për të cilën ai është penalizuar kishte ardhur në afatet e fundit, pas arrestimit të personave, se materiali i përgjimit i ndodhur në dosje ishte sjellë jashtë afatit ligjor prej 24 orësh, se kërkesën për lejim përgjimi, që ai i kishte bërë gjykatës, kjo e fundit nuk e kishte shqyrtuar, pasi ishte dërguar me vonesë. Subjekti, po ashtu është shprehur se për vleftësimin e paligjshëm të kontrollit të një banese, ai kishte pasur bindjen e tij. Subjekti e përshkruan penalizimin për shkak se çështja kishte pasur impakt.

- Trupit gjykues nuk i rezultoi që masa disiplinore e dhënë ndaj subjektit, të ishte kundërshtuar prej, për shkaqet dhe arsyet që subjekti parashtron në prapsimet e Komisionit.

→ Nga raporti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisionit i rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit ishin bërë katër kallëzime⁴¹ në vitet 2016 dhe 2017, në organin e akuzës, më konkretisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilat organi i prokurorisë kishte vendosur pushimin apo edhe mosfillimin e procedimeve.

- Trupit gjykues në analizim të akteve i rezultoi se përgjithësisht vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit ishte lënë në fuqi në organin e gjyqësorit apo se ndaj tyre nuk ishte ushtruar ankim.

→ Gjithashtu, Komisioni në raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, konstatoi se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2018 kishin rezultuar ankesat si vijon, të cilat rezultuan se ishin trajtuar me përgjigje nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Praktika nr. (***) e vitit 2006 që i përket ankesës së shtetasit K. B., sikurse është shprehur Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin e tij, Komisionit i rezultoi se: *“Dënimi i ankuesit me një vit burgim për veprat penale të parashikuara nga nenet 290/1 dhe 273 të Kodit Penal, me vendimin nr. 106, datë 4.11.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka mbetur në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 290, datë 28.5.2003”*.

- Praktikant nr. (***) dhe nr. (***) të vitit 2011, që i përkasin ankesës së shtetasit B. Gj., mbi vendimin e pushimit me nr. (***) të vitit 2011 të marrë nga subjekti, se vendimi është i pabazuar në ligj e në prova, por dhe se ankuesi pretendon se është kërcënuar me pistoletë nga ana e subjektit, Komisionit i rezultoi, ashtu sikurse shprehet në raportin e tij Këshilli i Lartë i Prokurorisë, se ndaj vendimit të pushimit, të procedimit me nr. (***) të vitit 2001, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe se çështja është ende në shqyrtim.

- Praktika nr. (***) e vitit 2014, që i përket ankesës së shtetasit P. N., se subjekti i rivlerësimit nuk ka karakteristikat e duhura për të qenë prokurori i çështjeve të kallëzuara nga ai. Komisionit, ashtu sikurse shprehet edhe në raportin e tij, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i rezultoi se procedimi penal nr. (***) i vitit 2010 për veprën penale *“falsifikim i dokumenteve”*, parashikuar nga neni 186, i Kodit Penal është pushuar me vendimin e datës 25.9.2014 dhe se nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar në gjykatë prej tij. Po ashtu, Komisionit i rezultoi se edhe procedimi penal nr. (***) i vitit 2013, për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal, është aktualisht në fazën përfundimtare të gjykimit.

⁴¹ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 10.5.2018, në të cilin pasqyrohet kallëzimi penal nr. (***) i vitit 2017, kallëzimi penal nr. (***) i vitit 2017, kallëzimi penal nr. (***) i vitit 2016, kallëzimi penal nr. (***) i vitit 2017.

- Praktika nr. (***) e vitit 2018, që i përket ankesës së shtetas F. e Sh. L. . Komisionit, ashtu sikurse shprehet në raportin e tij Këshilli i Lartë i Prokurorisë, por edhe pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, i rezultoi se për vendimin e mosfillimit të procedimit penal të depozituar prej tij nuk është ushtruar ankim.

- Praktika nr. (***) e vitit 2018, që i përket ankuesit M. Gj.⁴², se çështja e kallëzuar prej tij nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë nga subjekti, Komisionit ashtu sikurse shprehet në raportin e tij edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i rezultoi se çështja është trajtuar edhe në rrugë gjyqësore.

✓ Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve në ankime, të përgjigjeve të dhëna nga organi i prokurorisë për secilën prej tyre, të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të akteve⁴³ të depozituara prej këtij të fundit, i rezultoi se për praktikën nr.(***)të vitit 2006, vendimmarrja e subjektit ka mbetur në fuqi në organin e gjyqësorit; për praktikën nr. (***) dhe nr. (***) të vitit 2011 vijon shqyrtimi në organin e gjyqësorit; për praktikën nr. (***) të vitit 2014, për procedimin penal nr. (***) të vitit 2010, për veprën penale “*falsifikim i dokumenteve*” është pushuar me vendimin e datës 25.9.2014 dhe se nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar në gjykatë, në lidhje me praktikën nr. (***) të vitit 2018, ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk ishte ushtruar ankim, ndërsa çështja që i përket ankesës nr. (***) të vitit 2018, është trajtuar edhe në rrugë gjyqësore nga ku është vendosur rrëzimi i ankimit.

➔ Në lidhje me kallëzimet, trupit gjykues pas analizimit të tyre i rezultoi se:

- Kallëzimi penal nr. (***) i vitit 2017⁴⁴, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimmarrjen me nr. 98/53-2017-1172 vendimi të datës 2.5.2017, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së shtetasit P. Ll.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimmarrjen nr. 172, datë 6.11.2017.

- Kallëzimi penal nr. (***) i vitit 2016, i shtetasve V. P. dhe D. P. për të cilin është vendosur: “Mosfillim i procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. (***) të vitit 2016”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të shtetasve P.”.

- Kallëzimi penal nr. (***) i vitit 2017, për të cilin subjekti ka vendosur: “Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. (***) të vitit 2017”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të shtetasit M. S.”.

✓ Në tërësi për sa i përket denoncimeve, disa prej të cilëve i ka parashtruar edhe raporti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë trajtuar si kallëzime (të drejtuara nga të njëjtët shtetas), pranë organit të prokurorisë me vendim pushimi apo mosfillimi, vendime të cilat kanë kaluar në shkallët e gjyqësorit duke mbetur në fuqi.

➔ Komisioni nisur nga gjetjet në raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por edhe nga informacioni i dhënë në raportin e DSIK-së, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës edhe dy dosje penale, përkatësisht të vitit 2006 dhe 2010 të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

⁴² Shtetasi Gj. ka paraqitur edhe në Komision, denoncimet nr. (***) prot., datë 30.4.2018 dhe nr(***)prot., datë 6.9.2018

⁴³ Vendimet gjyqësor nr. 97, datë 2.12.2013, nr. 14 datë 15.12.2013 dhe nr. 31, datë 15.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, kërkesa për gjykimin e çështjes nr. (***) të vitit 2018, dhe ankimi kundër vendimit të gjykatës, vendim për mosfillimin e procedimit penal, vendim për pushimin e procedimit nr. (***) të vitit 2014, dhe vendimi nr. 195, datë 18.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁴⁴ Shtetasi Ll. ka paraqitur në Komision denoncimin nr. (***) prot., datë 8.1.2019.

Dosja penale nr. 1

Çështja penale në ngarkim të të pandehurit M. K., i akuzuar për veprën penale “Kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga neni 174, i Kodit Penal, dënuar me 160,000 lekë gjobë me vendim të formës së prerë.

Rrethanat e çështjes

- Nga aktet e administruara në fashikullin penal, referohet se në datën 21.3.2006 nga shërbimi i policisë kufitare të Kosovës është marrë informacion se në pjesën e sipërme të pikës doganore Morinë disa persona po kalonin mallra kontrabandë, konkretisht viça, dhe se më pas është bërë kapja dhe sekuestrimi i tyre.
- Në arsyetimin e urdhrin të lartpërmendur pasqyrohet se në datën 21.3.2006 nga forcat e policisë është bërë kapja e një sasive mallrash kontrabandë 16 krerë viça.
- Në datën 22.3.2006 në mjediset e Komisarariatit të Policisë Kukës është paraqitur vetë shtetasi M. K., duke deklaruar se viçat ishin të tijët pasi i kishte blerë.
- Policia Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Kukës, në datën 22.3.2006, ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit M. K., për atribuimin e veprës penale “kontrabandë”, të parashikuar nga neni 174⁴⁵ i Kodit Penal.
- Me procesverbalin për këqyrjen e provës materiale, të datës 22.3.2006 të ndaluarit i janë bllokuar disa deklarata të shtetasve të ndryshëm për shitje të krerëve.
- Nga fashikulli penal rezulton se kjo çështje është referuar nga Policia Gjyqësore e Qarkut Kukës në datën 23.3.2006 në ngarkim të shtetasit M. K. .
- Po në të njëjtën datë është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. (***) , ndaj personit të cilit i atribuohet vepra penale, duke u caktuar edhe prokurori për hetimin e këtij procedimi.
- Në fashikull rezultojnë të administruara aktet mbi kryerjen e veprimeve hetimore⁴⁶.
- Gjykata, me vendimin nr. 18, datë 25.3.2006, ka vendosur “*arrest në burg*” për këtë të pandehur, parashikuar nga neni 238⁴⁷ i Kodit të Procedurës Penale.
- Në datën 29.3.2006 çështja penale është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në ngarkim të këtij të pandehuri, për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal.

⁴⁵ Kodi penal/ Neni 174/Kontrabanda me mallra të tjera/ *Importimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave, nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore, fshehjes së plotë apo të pjesshëm, mosdeklarimit të saktë në doganë, deklarimit të rremë për natyrën, llojin, cilësinë, çmimin, destinacionin e mallit apo të tjera forma që kanë për qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohen me gjobë ose burgim gjer në pesë vjet.*

⁴⁶ Procesverbal për sekuestrimin e provës materiale, datë 22.3.2006; Procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale, datë 22.3.2006; Autorizim i Prokurorit të Rrethit Gjyqësor Kukës për caktimin e OPGJ-së me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore; Vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-veterinar, datë 22.3.2006; Vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-veterinar, datë 22.3.3006; Aktekspertimi mjeko-veterinar, datë 22.3.2006; Vendim për arrestimin në flagrancë, datë 22.3.2006; Procesverbal datë 22.3.2006 për deklarimet nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet; Procesverbal datë 23.3.2006 për njoftimin e akuzës; Procesverbal datë 28.3.2006 i pyetjes së të pandehurit; Procesverbale datë 22.3.2006, për deklarime nga persona që tregojnë rrethanat e hetimit; Vendimi për vlerësimin e sekuestrros, datë 24.3.2006; Vendim për kryerjen e ekspertimit kontabël; Aktekspertimi kontabël, datë 22.3.2006; Deklaratë dore të disa shtetasve (pa datë); Procesverbal për marrjen e dorëshkrimeve eksperimentale të akuzuarit M. K., datë 22.3.2006; Procesverbal për marrjen e dorëshkrimeve eksperimentale shtetasit Q. T., datë 22.3.2006, së bashku me dorëshkrimet e këtij shtetas; Urdhër për krijimin e Komisionit të shitjes së provës materiale, datë 22.3.2006; Urdhër për shitjen e sendeve të sekuestruara, datë 22.3.2006; Procesverbal për shitjen e provës materiale të sekuestruar, datë 22.3.2006; Kërkesë për vlefësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*”, datë 23.3.3006, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale; Relacion i OPGJ-së, datë 28.3.2006, për përfundimin e hetimeve ku sugjerohet dërgimi në gjyq i çështjes penale nr. (***) , datë 23.3.2006, në ngarkim të pandehurit M. K., për veprën penale “kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal;

⁴⁷ Neni 283/ Kallëzimi nga ana e shtetasve/ **1.** Çdo person që ka marrë dënim për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm./**2.** Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit...

- Në datën 29.3.2006, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës ka kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. (***)/2006 në ngarkim të këtij të pandehuri, për veprën penale të sipërcituar.
- Gjykata, me vendimin nr. 21, datë 3.4.2006, ka vendosur: *“deklarimin fajtor të këtij të pandehuri, për kryerjen e veprës penale të kontrabandës”*, të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e ka dënuar atë me 240,000 lekë gjobë dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale përfundimisht i pandehuri është dënuar me 160,000 lekë gjobë.
- Sipas akteve të administruara në fashikullin hetimor të kësaj çështjeje dukej se subjekti kishte nisur veprimet në këtë proces vetëm me depozitimin e konkluzioneve përfundimtare pranë organit të gjyqësorit të datës 3.4.2006.
- Në konkluzionet përfundimtare, ndër të tjera ai kishte parashtruar se *në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit mendoj të kihen parasysh; përhapja e kësaj vepre në vendin tonë; rrezikshmëria e saj shoqërore; sanksioni që parashikon dispozita përkatëse; rrethanat në të cilat është kryer; faktin se parashikohet si krim ekonomik (i cili ka cenuar sistemin doganor duke prekur interesat shtetërore nga mosnxjerrja e taksave doganore të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale), rrezikshmërinë shoqërore e të pandehurit si dhe rrethana të tjera që i çmon vetë gjykata.*
- Mbi këto konkluzione subjekti kishte kërkuar: *Deklarimin fajtor të këtij të pandehuri për kryerjen e veprës penale të lartpërmendur, parashikuar nga neni 174, i Kodit Penal dhe po në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 250,000 lekë, si dhe kalimin e vlerës së mallit të sekuestruar me procesverbalin, datë 22.3.2006, në shumën prej 308,400.14 lekësh, në favor të shtetit.*
- Në konkluzionet përfundimtare, subjekti, kishte renditur disa elemente, që në vlerësim e tij duhet të çonin gjykatën në dënimin e të akuzuarit me gjobë dhe jo me ndonjë masë tjetër dënimi kur vetë dispozita ligjore e njeht dënimin në këtë rast, gjobë deri në 5 vjet burgim.
- Nga veprimet procedurale nuk rezultoi që subjekti të kishte dhënë argumente bindës lidhur me propozimin për dënim minimal të të pandehurit.
- Nga aktet e fashikullit penal nuk rezultoi të ishte administruar vërtetim i gjendjes gjyqësore për të akuzuarin, me qëllim provueshmërinë e ekzistencës së rrezikshmërisë së kryerjes së veprës penale nga i akuzuari, si dhe fakti nëse i akuzuari kishte qenë ndonjëherë përsëritës apo jo, për më tepër për të njëjtën vepër penale.
- Mbi këtë mungesë dokumentacioni të rëndësishëm nuk rezultoi të kishte lënë gjurmë verifikuese dhe më tej ndërmarja e kërimit nga subjekti pranë institucioneve kompetente.
- Komisioni me shkresën nr. (***) prot., datë 13.5.2019, i ka kërkuar informacion Zyrës së Regjistrimit Gjyqësor pranë Ministrisë së Drejtësisë, nëse ky i dënuar ka qenë edhe më parë i dënuar.
- Sektori i Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. V-(***) prot., datë 14.5.2019, ka informuar se shtetasi M. K ka qenë i dënuar me vendimin nr. 32, datë 17.3.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për veprën penale të kontrabandës, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal, dhe është dënuar me 1 vit burgim për veprën penale të kontrabandës.
- Në datën 28.4.2006 rezultoi se subjekti kishte urdhëruar ekzekutimin e vendimit me gjobë.
- Në fashikull rezultuan të administruara veprimet përmbartimore lidhur me ekzekutimin e dënimit me gjobë.
- Nga aktet rezultoi se në datën 14.7.2006, Zyra Përmbartimore Kukës kishte kthyer për kompetencë sipas nenit 34, të Kodit Penal dhe nenit 467⁴⁸ të Kodit të Procedurës Penale,

⁴⁸ Neni 467/ Ekzekutimi i dënimeve me gjobë 1.Vendimet që përmbajnë dënimin me gjobë ekzekutohen nga zyra e përmbartimit./ 2. Kur vërtetohet pamundësia e marrjes së gjobës ose e një pjese të saj, prokurori i bën kërkesë gjykatës që ka dhënë vendimin për të bërë konvertimin. Me kërkesën e të dënuarit, gjykata mund ta shtyjë konvertimin deri në gjashtë muaj.

pranë organit të Prokurorisë Kukës, dosjen penale së bashku me vendimin përkatës, me shkakun se nuk ishte ekzekutuar vendimi me gjobë.

- Në datën 19.7.2006, bazuar në nenin 462/2⁴⁹ të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i ishte drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me kërkesë për konvertim dënimi, duke kërkuar konvertimin e dënimit me gjobë, në burgim dhe llogaritur një ditë burgim me 5,000 lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me vendimin nr. 6, datë 5.2.2007, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 387⁵⁰ të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur *Pushimin e çështjes*, me arsyetimin se i dënuari ka përfituar nga ligji nr. 9678, datë 13.1.2007, "Për dhënie amnistie"⁵¹, hyrë në fuqi në datën 1.2.2007. Ky vendim ka marrë formë të prerë.
- Më tej, me cilësinë e të ngarkuarit për ekzekutimin e vendimeve, në datën 5.2.2007, subjekti kishte urdhëruar shfuqizimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit me gjobë.

- Dosja penale nr. 2

Procedimi penal që i përket vendimit të pushimit të çështjes penale nr. (*) , datë 29.4.2010, të personit nën hetim me iniciale I. H., i hetuar nën masë sigurimi personal "Garanci pasurore", i akuzuar për veprën penale "Tregtim dhe transportim i mallrave që janë kontrabandë", parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal.**

- Rezulton se në vendimin e pushimit datë 29.4.2010, subjekti ka renditur disa veprime hetimore të kryera ndaj të akuzuarit I. H., në përfundim të të cilave kishte konkluduar se nuk vërtetohet se mallrat e sekustruara të jenë me origjinë kontrabandë.
- Nga aktet vërehet se procedimi penal është regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës në datën 16.3.2010.
- Sipas relacionit të OPGJ-së, datë 16.3.2010, lidhur me rrethanat e çështjes, është pasqyruar se rreth orës 02:30, Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës në vendin e quajtur Qafë Shkallë ka ndaluar, ka kontrolluar e më pas ka shoqëruar në mjediset e policisë automjetin tip "Benz", kamion me targë (***) , në pronësi të të akuzuarit, i cili drejtohej nga shtetasi A. M. Dyshohej se me këtë automjet po transportoheshin mallra kontrabandë (disa materiale hekuri skrap dhe disa kuti), nga Kosova për Shqipëri dhe po transportoheshin drejt Tiranës.
- Vërehet se në deklarinimin e tij shtetasi I. H., në datën 16.3.2010, ka deklaruar se mallin e ka blerë prej tre muajsh në treg të lirë dhe pjesë-pjesë në Tiranë, nga 5 arka për të cilat është shprehur ai ...nuk më kanë dhënë faturë tatimore dhe TVSH-je, duke pritur që të rritej çmimi dhe ta dërgonte në Tiranë për ta shitur në treg të lirë.
- Nga deklarimi i shtetasit A. M. (shoferit të automjetit) konstatohet të ketë thënë se ai nuk ka pasur dijeni për mallin e ngarkuar.
- Me procesverbalin datë 16.3.2010 është dokumentuar këqyrja dhe marrja e provës materiale, automjeti i lartpërmendur, 400 kuti kartoni me mbishkrimin INCANDESCENT LAMPS, me nga 100 copë secila, llamba elektrike.

Kjo periudhë nuk llogaritet në afatet e parashkrimit.3. Kundër vendimit të konvertimit mund të bëhet ankim, i cili pezullon ekzekutimin e tij.

⁴⁹ Neni 462/Vendimet e ekzekutueshme 1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë./2.Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes

⁵⁰ Neni 387/ Vendimi i pushimit të çështjes/ 1. Kur ndjekja penale nuk duhej të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun..

⁵¹ LIGJI Nr. 9678, datë 13.1.2007/PËR DHËNIE AMNISTIE/ Neni 1/ 1. Amnistohen...personat e dënuar me gjobë, si dhe personat e dënuar me burgim ose dënime më të lehta, të cilëve, në datën 31 dhjetor 2006, u kanë mbetur, pa vuajtur nga ky dënim, deri në 2 vjet, me përjashtim të parashikimeve të nenit 3 të këtij ligji./ **Neni 4/Për efekt të zbatimit të këtij ligji, quhen të dënuar: a) personat e dënuar nga gjykata e shkallës së parë që, brenda afatit ligjor, nuk kanë bërë ankim ose apel në gjykatën e apelit;.../Neni 5/ ..., për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, ...për veprat penale të kryera deri në datën 31 dhjetor 2006, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë.**

- Në relacionin e OPGJ-së pasqyrohet fakti se Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Kukës me shkresën nr.(***), datë 2.4.2010, ka konfirmuar se shtetasi I. H., *ka kaluar në pikën e kalimit kufitar Morinë vetëm me autoveturë dhe fugon dhe nuk rezulton të ketë kaluar me kamion me targë (***)*.
- Në vendimin e pushimit citohet se shtetasi I. H., sipas këtij konfirmimi nuk rezulton të ketë hyrje-dalje në/nga Republika e Shqipërisë, me automjetin me targë (***) , për periudhën 18.1.2010 – 16.3.2010.
- Në procesverbalin e arrestimit në flagrancë, datë 16.3.2010, thuhet: *“...automjeti dyshohej se po transportonte mallra kontrabandë nga Kosova për Shqipëri dhe po i transportonin në drejtim të Tiranës...”*
- Në referimin e veprës penale nga OPGJ-ja, datë 16.3.2010, pasqyrohet se shtetasi I. H., ka deklaruar se mallin e kishte blerë prej tre muajsh: *“...nuk më kanë dhënë faturë tatimore dhe TVSH-je”*. Ky fakt pasqyrohet edhe në procesverbalin e marrjes së të dhënave të akuzuarit I. H., në datën 16.3.2010, ora 09:00, nga OPGJ-ja, madje pasi është pyetur, ka ritheksuar: *“..se nuk kisha faturë për të..”*
- Në procesverbalin, datë 16.3.2010, ora 17:00, me të cilin subjekti kishte marrë në pyetje të arrestuarin, ai ndër të tjera është shprehur: *“... ka qenë i pajisur me fatura tatimore por kur ka kontrolluar në dyqan nuk i ka gjetur... dhe se nuk mbante mend se ku i kishte lënë...”*
- Në datën 17.3.2010 në kërkesën e tij për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit, subjekti kishte cituar shprehimisht se ky person është kapur në kryerje e sipër të krimit, pra, të transportimit dhe të tregtimit të mallrave, që dihet se janë kontrabandë, jo vetëm për faktin se janë pa origjinë, por, siç deklaroi dhe vetë i arrestuari, mallin e ka blerë në Kosovë dhe e ka nxjerrë pjesë-pjesë në territorin shqiptar.
- Në urdhrin e subjektit për delegimin e veprimeve hetimore, datë 18.3.2010, thuhet se *i pyetur paraprakisht shtetasi I. H., ka deklaruar se malli ishte i tij, por ai nuk dispononte asnjë dokument për të provuar origjinën e tij*.
- Në vendimin për vleftësimin e sekuestros së disa dokumenteve dhe të automjetit, datë 18.3.2010, subjekti kishte cituar shprehimisht se shtetasi I. H., ka deklaruar se mallin e kishte blerë pjesë-pjesë në Kukës, që prej tre muajsh... po e dërgonte në Tiranë, *pa i provuar deklaratimet me fatura shitblerjeje të mallit*.
- Në relacionin, datë 29.4.2010, OPGJ-ja kishte pasqyruar deklaratimet e të akuzuarit, ku ndër të tjera konstatohet të jetë cituar se kur është ndaluar nga policia dhe kur është pyetur se me se është i ngarkuar automjeti, *deklaroi se atë ditë nuk i ka pasur faturat me vete, ka kontrolluar në dyqan për t'i gjetur dhe nuk i ka gjetur dhe është nisur në orët e vona drejt Tiranës dhe se pas disa ditëve ka kontrolluar në dyqan dhe i ka gjetur faturat për mallrat, që vërtetojnë origjinën të cilat i ka dorëzuar*.
- Në vendimin e pushimit subjekti ka pasqyruar një tjetër version, duke cituar se sipas deklaratimeve të të akuzuarit, *ai ka deklaruar se e ka blerë mallin e sekuestruar sipas faturave tatimore të shitjeve*.
- Po në këtë vendim subjekti ka cituar tri fatura tatimore me numra serie përkatësisht: fatura nr. (***) , nr. (***) dhe nr. (***) të datave përkatëse: datë 1.3.2010, datë 5.3.2010 dhe datë 9.3.2010.
- Sipas këtij pasqyrimi rezulton se i akuzuari i ka pasur faturat përpara ndalimit të tij datë 16.3.2010 dhe se duke qenë në dijeni të tyre, kurrsesi nuk do të kishte deklaruar se nuk dispononte asnjë dokument për të provuar origjinën e mallit.
- Në urdhrin e delegimit të veprimeve hetimore subjekti kishte përcaktuar edhe kryerjen e veprimeve hetimore deri në datën 30.3.2010.
- Me urdhrin datë 24.3.2010 subjekti kishte urdhëruar kthimin e automjetit shtetasit I. H., së bashku me dokumentacionin e sekuestruar, me arsyetimin se veprimet me të janë kryer dhe

se duhen kryer një sërë veprimesh hetimore për të vërtetuar nëse malli i sekuestruar është apo jo me origjinë kontrabandë, si dhe lënien e mallin në ruajtje të të akuzuarit pa të drejtë shitje.

→ Pas analizimit dhe trajtimit të këtyre dosjeve, Komisionit i rezultoi dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe provuar të kundërtën, se në Çështjen penale në ngarkim të të pandehurit M. K. akuzuar për veprën penale “Kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga neni 174, i Kodit Penal, dënuar me 160,000 lekë gjobë, me vendim të formës së prerë:

- Gjatë studimit dhe analizimit të kësaj dosje, Komisioni konstatoi se hetimet ishin kryer nga një subjekt tjetër rivlerësues, dhe se në fashikullin hetimor nuk rezultonte të ishte administruar asnjë akt që pasqyrore zëvendësimin e prokurorit të mëparshëm të çështjes me subjektin e rivlerësimit.
- Po ashtu, në kërkimin e subjektit për konvertimin e dënimit rezultoi se ai kishte aplikuar si bazë ligjore një dispozitë që nuk kishte lidhje me objektin e kërkimit, pasi duhej aplikuar neni 467/2, i Kodit të Procedurës Penale.
- Komisioni nga korrespondenca që mbajti me Zyrën e Regjistrat Gjyqësor pranë Ministrisë së Drejtësisë ra në dijeni të faktit se i pandehuri në këtë procedim penal kishte qenë i dënuar edhe më parë për të njëjtën vepër penale, ndërkohë që;
- Nga verifikimi i akteve në dosjen penale, nuk rezultoi të ishin kryer hetime në lidhje me faktin se i akuzuari kishte qenë përsëritës ose jo për të njëjtën vepër penale dhe për rrjedhojë:

✓ Dukej se me veprimet dhe mosveprimet e tij, subjekti kishte parashtruar ngritjen e akuzës duke anashkaluar faktin se i pandehuri kishte qenë përsëritës për të njëjtën vepër penale “kontrabandë”, me pasojë favorizimin e dënimit të tij në minimumin e kërkuar nga ligji.

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti ndër të tjera ka kundërshtuar duke cituar... nga verifikimi i dosjes nga ana ime, më rezulton se nuk kam qenë i ngarkuar me hetimin e çështjes, ajo është hetuar nga drejtuesi i prokurorisë, dhe është dërguar në gjyq me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë. Kërkesa dhe vendimi i dërgimit të çështjes në gjyq, është bërë nga ish-drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Më rezulton se unë kam përfaqësuar akuzën, vetëm në një seancë gjyqësore, datë 03.04.2006, kur është shqyrtuar çështja me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë.

Sigurisht në seancë gjyqësore kam marrë pjesë me autorizimin e Drejtuesit të Prokurorisë, pasi nuk ishte çështje e hetuar nga ana ime. Përfaqësimi i akuzës dhe kërkimet në llojin e masës së dënimit për të pandehurin në fjalë, janë bërë me autorizim dhe, pasi është marrë mendimi apo vendimi nga Drejtuesi i Prokurorisë në atë kohë, qoftë i dhënë me gojë qoftë me shkrim, sipas funksionimit në mënyrë të centralizuar të organit të prokurorisë në atë kohë. Akti për verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe standardeve procedurale, merret dhe administrohet në fazën e hetimeve paraprake, pa u dërguar çështja në Gjykatë. Sa i përket faktit se në dosje nuk ka një akt zëvendësimi të prokurorit, më rezulton se çështja është dërguar për gjykim nga drejtuesi i prokurorisë, dhe për rrjedhojë nuk ka një akt zëvendësimi të prokurorit, pasi siç theksova me sipër, unë kam marrë pjesë vetëm në të vetmen seancë gjyqësore atë të dhënies së konkluzioneve të diskutimit përfundimtar, ku sigurisht kam shkuar me autorizimin e drejtuesit të prokurorisë. Gjetja juaj se në kërkesën drejtuar Gjykatës, për konvertimin e dënimit, është cituar si bazë ligjore neni 462/2 dhe jo neni 467/2 i Kodit të Procedurës Penale, pavarësisht se nuk e kam parë këtë dokument, vlerësoj se është një lapsus në të shkruar, nga nxitimi dhe nga ngarkesa, pasi sigurisht baza ligjore është neni 467/2 i Kodit të Procedurës Penale.

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni pas kundërshtimeve të subjektit lidhur me këtë çështje konstaton se:

- Subjekti nuk depozitoi aktin për zëvendësimin e tij vetëm në fazën e konkluzioneve përfundimtare.
- Subjekti sikurse deklaroi në seancë, është hartuesi i konkluzioneve përfundimtare dhe për pasojë bën edhe verifikimin e akteve të ndodhura në dosje, që në rastin konkret duhet të kishte verifikuar depozitim në dosje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore, për shkak se mbi akte dhe prova bën edhe argumentimin në konkluzione.
- Subjekti ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 484⁵², të Kodit të Procedurës Penale, si dhe urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 174, datë 5.9.2003, “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”.
- Ndryshe nga sa ka vepruar subjekti në hartimin e këtyre konkluzioneve për të cilat nuk ka kryer verifikimin e aktit të gjendjes gjyqësore dhe për pasojë nuk është shprehur mbi dënueshmërinë e të pandehurit si përsëritës, në konkluzionet e tij në dokumentin ligjor nr. 4, të trajtuar më sipër ka kërkuar dëshminë e penaltetit dhe ka administruar atë në dosjen penale, duke vënë theksin edhe në faktin se i pandehuri ka qenë i padënuar më parë.

→ Çështja e dytë e trajtuar nga Komisioni i përkiste procedimit penal të vendimit të pushimit të çështjes penale nr. (***) , datë 29.4.2010, të personit nën hetim me initiale I. H., i hetuar nën masë sigurimi personal “garanci pasurore”, i akuzuar për veprën penale “Tregtim dhe transportimit të mallrave që janë kontrabandë”, parashikuar nga neni 178, i Kodit Penal.

Gjatë studimit dhe analizimit të kësaj dosje, Komisioni konstatoi se hetimi nuk ishte kryer i plotë, si dhe nuk ishin mbledhur të gjitha provat për qartësimin e rrethanave të akuzës së ngritur, si vijon:

- ✓ Nuk rezultonte të ishte ndërmarrë asnjë veprim, me cilësinë, me rolin dhe me kompetencën që prokurorit i jep ligji, lidhur me deklarinimet e njëpasnjëshme kontradiktore, brenda një dite të të arrestuarit për faturat tatimore të mallit.
- ✓ Dukej se prej subjektit ishin dhënë versione kontradiktore në aktet e hartuara nga vetë subjekti, siç ishin: akti “Për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit”; vendimi për vleftësimin e sekuestros, në datën 18.3.2010; urdhri i delegimit për veprime hetimore, në datën 18.3.2010; si dhe vendimi i pushimit.
- ✓ Dukej se nga subjekti nuk ishin kryer veprime hetimore ndaj firmës private prej së cilës ishin lëshuar faturat tatimore, për të siguruar një vendimmarrje të drejtë mbi origjinën e mallit, nëse ishte apo jo kontrabandë.
- ✓ Dukej se nga subjekti nuk ishin ndërmarrë veprime hetimore lidhur me faktin nëse mallrat e tregtuara nga firma private ishin të zhdoganuara apo të blera nga një tjetër biznes.
- ✓ Dukej se nga subjekti nuk ishin kryer veprime hetimore lidhur me faktin nëse aktiviteti i firmës prej së cilës ishin lëshuar faturat tatimore tregtonte mallra të kësaj natyre.
- ✓ Nuk rezultonte të ishin administruar në dosje akte me veprime hetimore të cilat hedhin dritë mbi këqyrjen e librave të shitjes.

⁵² Neni 484/ Vërtetimet e gjendjes gjyqësore 1. Organet e drejtësisë, të administratës shtetërore dhe entet e ngarkuara me shërbime publike kanë të drejtë të marrin vërtetimin e shënimeve për një person të caktuar, kur vërtetimi është i nevojshëm për kryerjen e funksioneve të tyre. 2. Prokurori mund të kërkojë vërtetimin e sipërm për të pandehurin ose të dënuarin dhe, me autorizim të gjykatës ai dhe mbrojtësi mund të kërkojnë vërtetim edhe për personin e dëmtuar dhe dëshmitarët...

✓ Nuk rezultonte të ishin administruar në dosje akte që provonin kryerjen e veprimeve hetimore lidhur me verifikimin e bllokut të TVSH-së mbi bazën e të cilave kishin dalë këto fatura, pra, për të parë nëse faturat me numra serialë të lëshuara përpara faturave të dorëzuara nga i akuzuari datonin ose jo përpara datës së këtyre të fundit.

✓ Nuk rezultonte të ishin administruar në dosje akte të cilat pasqyronin kryerjen e veprimeve hetimore lidhur me verifikimin në drejtorinë tatimore përkatëse për faktin nëse ishin deklaruar këto fatura tatimore (me numrat serialë përkatës).

✓ Dukej se në kryerjen e veprimeve hetimore nuk ishte bashkëvepruar me organet Tatimore me qëllim konfiskimin e të gjithë sasisë së mallit, që transportohej, i pashoqëruar me dokumente tatimore, por thjesht dhe vetëm ishte lënë prej subjektit në ruajtje e për më tepër më pas prej subjektit ishte bërë edhe kthimi i mallit të akuzuarit.

✓ Dukej se me veprimet dhe mosveprimet subjekti kishte favorizuar në kohë të akuzuarin, me qëllim marrjen e faturave, dorëzimin e tyre (megjithëse ato datojnë shumë më herët kapjes së tij në flagrancë), me pasojë drejtimin e hetimeve drejt vendimmarrjes së pushimit të çështjes.

Në tërësi për këtë çështje, dukej se subjekti nuk kishte mbajtur të njëjtin standard hetimor sikurse kishte vepruar në hetimin që i përkiste njërit prej tri dokumenteve të përzgjedhur nga vetë ai i pasqyruar në raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe për këto i kaloi subjektit barrën e provës.

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti ndër të tjera ka kundërshtuar gjetjet duke cituar: *“Në datën 17 mars 2010, në kërkesën për vleftësimin e arrestimit dhe për caktimin e masës së sigurimit, kam cituar shprehimisht se ky person është kapur në kryerje e sipër të krimit, pra, të transportimit dhe të tregtimit të mallrave që dihet se janë kontrabandë, jo vetëm për faktin se janë pa origjinë, por siç deklarom dhe vetë i arrestuari, mallin e ka blerë në Kosovë dhe e ka nxjerrë pjesë-pjesë në territorin shqiptar. Në asnjë deklaram të tij, qoftë para oficerit të policisë gjyqësore, qoftë para prokurorit, personi nën hetim nuk ka thënë se mallin e ka blerë në Kosovë dhe e ka nxjerrë pjesë-pjesë në territorin shqiptar. Nga verifikimi i kërkesës, më rezulton se paragrafi i cituar më sipër është një gabim njerëzor i imi, nga mbivendosja e të shkruarit sipër ndonjë kërkesë tjetër. Është shkruar “Kukës” dhe jo “Kosovë” siç e citoni ju... Lidhur me konstatimin se: “Duket se kam dhënë versione kontradiktore në: kërkesën datë 17.3.2010, për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit; vendimin për vleftësimin e sekuistros, në datë 18.3.2010; urdhrin e delegimit për veprime hetimore, në datë 18.3.2010, si dhe vendimin e pushimit, datë 29.4.2010, sqaroj se:... “këto akte nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, megjithëse konstatoj se fabula e ngjarjes e cituar në to është e njëjtë...”. Lidhur me gjetjet e tjera për sa i përket kësaj çështjeje, shpjegoj se dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e një vepre penale dhe provimi i kryerjes së një vepre përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, janë dy koncepte të ndryshme juridike, njohur dhe sanksionuar në Kushtetutë dhe në ligj dhe për këtë citoj vendimin nr. 7, datë 4.11.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë...Nga verifikimi i akteve më rezulton është bërë këqyrja dhe marrja e faturave tatimore nga shoqëria përkatëse dhe nga verifikimi i tyre nuk kanë rezultuar dyshime mbi parregullshmërinë. Vendimi nuk është marrë vetëm bazuar në këto fatura, por në analizë tërësore të fakteve dhe të provave, i argumentuar në katër fletë. Vendimi i pushimit është miratuar edhe nga drejtuesi i Prokurorisë, i cili nuk ka parashtruar asnjë vërejtje mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe për këtë iu vë në dispozicion edhe kopjen e kapakut të dosjes. Në lidhje me hetimin e firmës që ka lëshuar faturat, shpjegoj se nuk ka pasur dyshime mbi aktivitetin e firmës, përderisa nga këqyrja e bllokut të faturave, kryer nga policia gjyqësore në datën 19.4.2010, nuk kanë rezultuar dyshime mbi parregullsinë e tij...Në lidhje me*

konstatimin tuaj se nuk kemi bashkëvepruar me organet tatimore me qëllim konfiskimin e të gjithë sasisë së mallit që transportohej i pashoqëruar me dokumente tatimore, por thjesht dhe vetëm e keni lënë atë në ruajtje e, për më tepër, keni bërë më tej kthimin e tij, të të akuzuarit, duke iu referuar nenit 121, të ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me duhet të sqaroj se referimi në këtë ligj është i gabuar, përderisa ishte reregjistruar një procedim penal, që prevalon mbi procedurën administrative. Dispozita e mësipërme e këtij ligji vlen për organet administrative të ngarkuara me zbatimin e këtij ligji dhe jo për prokurorin...” Në lidhje me konstatimin se: “Duket se me veprimet dhe me mosveprimet kam favorizuar në kohë të akuzuarin me qëllim marrjen e faturave, dorëzimin e tyre (megjithëse ato datojnë shumë më herët kapjes së tij në flagrancë), me pasojë drejtimin e hetimeve drejt vendimmarrjes së pushimit të çështjes”, shpjegoj se nuk kam favorizuar aspak, në asnjë moment, të akuzuarin, por vendimi është marrë pas një hetimi të plotë të çështjes, nga ku nuk është provuar se malli i sekuestruar i personit nën hetim të ishte me origjinë kontrabandë, ashtu sikurse është arsyetuar në vendim. Nga deklaratimet e marra përfaqësuesit të firmës, konfirmohet fakti i shitjes së mallit me faturë tatimore të shtetasit në fjalë... nga hetimi nuk u provua se malli i sekuestruar personit të akuzuar të ishte kontrabandë në kuptim të nenit 174, të Kodit Penal.

Përderisa, nuk u provua se malli ishte me origjinë kontrabandë, çështja është pushuar, duke përmendur këtu edhe parimin e prezumimit të pafajësisë, çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të akuzuarit.”

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Subjekti, në prapësimet e tij, vijon të trajtojë ligjshmërinë e firmës/aktivitetit privat të të akuzuarit me faktet se firma që administronte i akuzuari ishte e regjistruar në organin tatimor, se kishte likuiduar taksa e tatime dhe se i akuzuari nuk e kishte kaluar kufirin me automjetin e tij dhe se nuk kishte bërë zhdoganim e mallit.

Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje, arrin në konkluzion se nga subjekti nuk janë ndërmarrë veprimet hetimore për të provuar ligjshmërinë mbi origjinën e mallit të firma private ku pretendonte se e kishte blerë atë, si dhe nëse malli ishte apo jo kontrabandë.

Qëndrimi i subjektit është shumë i qartë dhe tërësisht kontradiktor, në aktet procedurale të masës së sigurimit, në urdhrin për delegimin e veprimeve hetimore dhe në vendimin për vleftësimin e sekuestros, ndërsa ai pretendon se fabula e ngjarjes është cituar e njëjtë.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv në përputhje me pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

Lidhur me anën profesionale: Trupi gjykues, gjatë analizimit të mangësive profesionale të konstatuara në aktet e përfaqësimit të organit të akuzës/ konkluzionet përfundimtare, në aktet procedurale, apo dhe në vendimarrje, i vlerësoi ato si veprime dhe mosveprime të kryera, jo për shkak të paaftësisë profesionale të subjektit, por me qëllim orientimin e palëve dhe favorizimin e të pandehurve në dhënien e dënimeve lehtësuese nga gjykata, si dhe shmangien e tyre nga dënimi.

Në përfundim të rivlerësimit profesional, Trupi gjykues krijoi bindjen se mangësitë profesionale të konstatuara, nuk mund të çojnë në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1 /c, të nenit 59

të ligjit nr.84/2016, por dëshmojnë, për sjellje të subjektit në favor të të pandehurve, si dhe në mospërbushje të detyrës së tij në pozicionin e prokurorit, duke cënuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

C. KONTROLLI I FIGURËS

- Rezultatet në lidhje me kontrollin e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, përmes verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve (të mundshme) të papërshtatshme, me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar në Komision:

a. Raportin me shkresën nr. (***) prot., datë 2.11.2017, me konstatimin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

b. Ky institucion, pas kërkesës së Komisionit për përditësimin e këtij raporti, me shkresën nr. (***) prot., datë 14.12.2018, ka dërguar raportin e rishikuar me konstatimin për papërshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës. Ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. (***), datë 8.1.2019, të KDZH-së, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016.

c. Për informacionin e disponuar në raportin e deklasifikuar të DSIK-së, anëtarët e trupit gjykues, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar, lexuan informacionin e klasifikuar, në bazë të të cilit janë përpiluar raportet e DSIK-së.

Raporti i DSIK-së, veç të tjerash, ka informuar se:

- ✓ Bazuar në informacionin e ardhur nga institucioni i verifikimit rezultojnë se disponohen të dhëna të viteve 2006 dhe 2010, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptuese në disa çështje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës.
- ✓ Ngrihen dyshime për veprime korruptuese në sistemin e drejtësisë.
- ✓ Në rastet e evidentuara të korrupsionit pasiv pranë gjyqësorit Kukës, subjekti i rivlerësimit dyshohet të jetë përfshirë në korrupsion pasiv të prokurorit në disa procese penale ndaj shtetasve të akuzuar për kontrabandë, duke i dënuar me gjoba të lehta, edhe kur veprat kanë qenë të përsëritura.
- ✓ Gjatë vitit 2010, z. Shkëlzen Cena, dyshohet të jetë përfshirë në një rast korrupsioni në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës, duke orientuar personin e pandehur për kryerjen e veprimeve të caktuara, me qëllim ndryshimin ose lehtësimin e akuzës ndaj tij.
- ✓ Rasti i vitit 2010 e thekson edhe më tepër rolin në veprimtari të paligjshme të prokurorit Cena, pasi aty shfaqet një formë konkrete nëpërmjet së cilës ky prokuror ka abuzuar me detyrën për të realizuar favorizimin e të pandehurit, me qëllim përfitimin.
- ✓ Ka dyshime të arsyeshme se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në formën e takimit të qëllimshëm, në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së tij.
- ✓ Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.

- ✓ Informacioni që disponohet në ngarkim të SH. C., për implikim në veprimtari korruptuese të funksionarit të drejtësisë, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose për të moskryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.
- ✓ Vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta nga prokurori Shkëlzen Cena me palën/personin në fazën e hetimit apo gjykimit të një procedimi penal, është një marrëdhënie apo kontakt i papërshtatshëm, në shkelje të plotë të detyrës së tij funksionale.

Referuar kriterit profesional të trajtuar më sipër, Komisionit i rezultoi se çështjet profesionale në këto rezultate hetimi mbështetnin raportin e kontrollit të figurës dhe për pasojë i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në prapsimet e tij, ndër të tjera ka cituar “... dy qëndrime të ndryshme të organit verifikues, brenda një harku kohor prej një viti e një muaj, është absurd dhe i pakuptimtë. Këto konstatime janë abuzive, denigruese dhe fyese për mua dhe për familjen time, ndoshta, edhe të qëllimshme. Nuk jam përfshirë në asnjë veprimtari të paligjshme.

Çështjen e vitit 2006 e trajtova edhe më sipër, ku sqarova se si i është dhënë zgjidhja ligjore. Fakti se personi i akuzuar është dënuar me gjobë dhe jo me burgim, nuk do të thotë aspak se jam përfshirë në veprime korruptuese. Është e turpshme të thuhet një gjë e tillë, kur nuk ekziston asnjë e dhënë lidhur me këtë fakt të fabrikuar. Ligji i kohës, parashikonte edhe dënimin me gjobë...Thuhet apo raportohet se gjatë vitit 2010, dyshohet të jem përfshirë në një rast korrupsioni, duke orientuar personin e pandehur për kryerjen e veprimeve të caktuara, me qëllim ndryshimin ose lehtësimin e akuzës ndaj tij... E theksova edhe më sipër se çështja është zgjidhur mbi bazën e provave dhe të ligjit... Nuk kam favorizuar asnjë person për shkak të detyrës, por e kam përmbushur atë më së miri, përgjatë 21 vjetëve punë të ndershme e të përkushtuar...”.

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, pasi analizoi çështjen në tërësi, pretendimet e subjektit të parashtruara në ankim, si dhe provat e administruara në këtë dosje, për kriterin e kontrollit të figurës arrin në përfundimin se mbi konstatimet e DSIK-së për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit nuk mund të arrihet në konkluzion, për të provuar kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë arsye, e gjen të drejtë pretendimin e subjektit, se nuk ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

Ndërkohë, mbi dyshimet e ngritura në raportin e DSIK-së, në të dyja çështjet penale, vlerëson se ka rrethana që dëshmojnë për shmangie nga kryerja e disa veprimeve hetimore të rëndësishme, për favorizime të të akuzuarve në dhënien e dënimeve të lehta apo shmangien e tyre nga dënimi dhe për pasojë, në këtë drejtim trupi gjykues i ka çmuar ato në vlerësimin tërësor të cenimit të besueshmërisë ndaj publikut.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues çmon se:

- a. **Lidhur me kriterin e pasurisë**, subjekti i rivlerësimit i) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë nr.1, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, ii) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për aktmarrëveshjen siguruese të trajtuar në pikën 3, iii) ka njohur dhe pranuar dy akte noteriale me elementë të ndryshëm nga njëri tjetri për të njëjtin objekt shitje, përshkruar në pasurinë nr. 5, iv) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë e përshkruar në pikën 10, v) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë nr. 11, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, ka kryer deklaram të pasaktë për këtë pasuri vi) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë e përshkruar në pikën 12, vii) ka pamjaftueshmëri të mbulimit të pasurisë dhe shpenzimeve të kryera ndër vite (për vitet 2006, 2011, 2013, 2014 dhe 2015), me burimet financiare të deklaruara dhe dokumentuara, në total në vlerën 3 880 003 lekë.
- b. **Lidhur me kriterin e figurës**, mbi dyshimet e ngritura në raportin e DSIK-së, në të dy çështjet penale, trupi gjykues i ka çmuar ato në vlerësimin tërësor të cënimit të bësueshmërisë ndaj publikut.
- c. **Lidhur me kriterin profesional**, trupi gjykues, krijoi bindjen se mangësitë profesionale të konstatuara, nuk mund të çojnë në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1/ c, të nenit 59 të ligjit nr.84/2016, por i çmoi këto mangësi si sjellje të subjektivit në favor të të pandehurve në mospërmbyshje të rolit të prokurorit, duke cënuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, mbështetur në pikën 1, të nenit 59 të ligjit nr.84/2016, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit:

Nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, dhe nuk ka arritur një nivel të besueshëm në sistemin e drejtësisë, pasi është cënuar besimi i publikut.

PËR KËTO ARSYE:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe pikave 3, dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlzen Cena, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.6.2019

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Lulzim Hamitaj

Kryesues

Firdes Shuli

Anëtar

Brunilda Bekteshi

Relatore